



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 74/3 Prot

Durrës, më: 30.03.2026

V E N D I M

Nr. 48, datë 30.03.2026

PËR

**"MIRATIMIN E PROJEKT - STRATEGJISË SË PROFILIZIMIT TË FAKULTETIT
TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT, PËRMES NDËRKOMBËTARIZIMIT,
2025-2030"**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë"; të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të Statutit dhe të Rregullores së UAMD-së; të Vendimit të Senatit Nr.174, datë 17.12.2025; të Vendimit të Rektoratit Nr.4, datë 02.02.2026 pika 4; referuar shkresës Nr. 576/5 prot., datë 17.03.2026 të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, si dhe referuar Vendimit të Rektoratit Nr. 5, datë 18.03.2026 pika 3, në mbledhjen e datës 30.03.2026, Senati Akademik,

V E N D O S I:

1. Miratimin e Projekt - Strategjisë së Profilizimit të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit, përmes ndërkombëtarizimit për periudhën 2025-2030, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Administratori
 - Zv. Rektorët
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore
 - Drejtorët e Drejtorive
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi



**PROJEKT- STRATEGJIA E PROFILIZIMIT
TË FAKULTETIT TË TEKNOLOGJISË SË
INFORMACIONIT PËRMES
NDËRKOMBËTARIZIMIT
2025 – 2030**

Durrës, Shkurt 2026




QËLLIMI I PARË I STRATEGJISË: Transformimi i FTI në një mjedis akademik digjital dhe të qëndrueshëm

- ◆ Integrimi i teknologjive digjitale dhe IA në procesin mësimor dhe kërkimin shkencor.
- ◆ Modernizimi i laboratorëve të teknologjisë së informacionit dhe përmirësimi i infrastrukturës kompjuterike.
- ◆ Përdorimi i platformave dhe software-ve bashkëkohore për zhvillimin e aktiviteteve akademike dhe kërkimore.



QËLLIMI I DYTË I STRATEGJISË: Ndërkombëtarizimi i arsimit dhe kërkimit shkencor në FTI

- ◆ Rritja e numrit të partneriteteve me universitete europiane
- ◆ Zhvillimi i programeve të përbashkëta Master/Doktoraturë
- ◆ Angazhimi në projekte si Horizon Europe dhe Erasmus+
- ◆ Tërheqja e stafit akademik dhe studentëve ndërkombëtarë



QËLLIMI I TRETË I STRATEGJISË: FTI si pjesë e rëndësishme e zhvillimit të qytetit dhe rajonit të Durrësit

- ◆ Bashkëpunimi me Bashkinë dhe bizneset për projekte në fushën e teknologjisë dhe inovacionit digjital.
- ◆ Mbështetja e startUp-ve dhe nxitja e sipërmarrjes studentore në teknologjinë e informacionit.
- ◆ Përfshirja aktive e fakultetit në transformimin digjital të qytetit dhe rajonit.

Lista e Shkurtimeve

AKKSHI	Agjencia Kombëtare për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin
AKAFPK	Agjencia Kombëtare për Arsimin, Formimin Profesional dhe Kualifikimet
AKPA	Agjencia Kombëtare për Punësimin dhe Aftësitë
AKR	Agjencia Kombëtare për Rininë
AKSHI	Agjencia Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit
BE	Bashkimi Evropian
IAL	Institucion i Arsimit të Lartë
KiE	Këshilli i Evropës
KM	Këshilli i Ministrave
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sporteve
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
OJQ	Organizata Jo-Qeveritare
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
RASH	Rrjeti Akademik Shqiptar
RYCO	Regional Youth Cooperation Office (Zyra Rajonale e Bashkëpunimit Rinor)
SKR	Strategjia Kombëtare e Rinisë
TIK	Teknologjia e informacionit
UAMD	Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës
FTI	Fakulteti Teknologjisë së Informacionit

Pasqyra e lëndës

1. Përmbledhje dhe qëllimi i dokumentit strategjik

- 1.1. Lidhja e Strategjisë së Zhvillimit të UAMD me Misionin, Vlerat dhe Prioritetet Institucionale
- 1.2. Lidhja e Strategjisë së UAMD-së me Kuadrot Strategjike Ndërkombëtare për Arsimin dhe Kërkimin Shkencor
 - 1.2.1. Lidhja e Strategjisë së UAMD-së me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs – Agenda 2030, OKB)
 - 1.2.2. Lidhja e Strategjisë së UAMD-së me Strategjia e OKB-së për Rininë – “Youth 2030”
 - 1.2.3. Lidhja e Strategjisë së UAMD-së me Strategjia Evropiane për Rininë 2019–2027
 - 1.2.4. Lidhja e Strategjisë së UAMD-së me Hapësira Evropiane e Arsimit të Lartë (EHEA) – Procesi i Bolonjës
 - 1.2.5. Lidhja e Strategjisë së UAMD-së me Horizon Europe 2021–2027
 - 1.2.6. Lidhja e Strategjisë së UAMD-së me Barazinë Gjinore si Prioritet Strategjik në UAMD

2. Profilizimi i UAMD-së në kuadër të ndërkombëtarizimit

- 2.1. Analiza e Programeve të Studimit në UAMD
- 2.2. Studim rreth mundësive të riorganizimit të programeve ekzistuese, pranë UAMD-së
- 2.3. Objektivat Kryesore për të arritur ndërkombëtarizimin e programeve të studimit
- 2.4. Roli i Akreditimit në Strategjinë e Zhvillimit të UAMD-së
- 2.5. Plani i Ndërkombëtarizimit të Programeve në UAMD
- 2.6. Plani afatgjat për periudhën 2030-2040
- 2.7. Profilizimi i UAMD-së
- 2.8. Objektivat strategjikë dhe indikatorët e performancës (KPI)

3. Ruajtja e qëndrueshmërisë së UAMD-së

- 3.1. Metodologjia e hartimit të strategjisë mbi task numër 2, 3 dhe 4
- 3.2. Analiza SWOT për ruajtjen e qëndrueshmërisë së UAMD
- 3.3. Deklarata e Vizionit të UAMD

4. Përfshirja e studentëve në aktivitete kulturore, sportive, dhe kërkimore shkencore

- 4.1. Qëllimi Strategjik
- 4.2. Objektivat Specifikë
- 4.3. Nisma të propozuara
- 4.4. Indikatorë të matshëm (KPI)

5. Zhvillimi i marrëdhënieve të qëndrueshme me gjimnazet dhe komunitetin

- 5.1. Qëllimi Strategjik
- 5.2. Objektivat Specifikë
- 5.3. Nisma të propozuara
- 5.4. Indikatorë të matshëm (KPI)

6. Kërkimi shkencor

- 6.1. Vizioni dhe misioni i UAMD për kërkimin shkencor
- 6.2. Kërkimi Shkencor dhe Bashkëpunimi në nivel ndërkombëtar
- 6.3. Zhvillimi i Institutit Kërkimor – Shkencor
- 6.4. Revista Shkencore Interdisciplinary Journal of Research and Development e indeksuar në Scopus dhe Web of Science
- 6.5. Rankimi i UAMD-së

7. Përfshirja e UAMD-së në projekte kërkimore – shkencore

- 7.1. Strategjia dhe Vizioni
- 7.2. Çfarë është Durana
- 7.3. Treguesit e Suksesit
- 7.4. Ekosistemi i Startup-eve në Shqipëri dhe mundësitë për UAMD

8. Rrjetëzimi Akademik dhe potenciali gjeografik i UAMD

- 8.1. Strategjia dhe Vizioni
- 8.2. Aktivitete të Sugjeruara

9. Bashkëpunimi me Diasporën

- 9.1. Strategjia dhe Vizioni
- 9.2. Integrimi në rrjetet e diasporës akademike dhe kulturore
- 9.3. Veprimtaritë dhe aktivitetet kryesore QSPA

10. Integrimi i Praktikave Profesionale në kurrikulat e programeve tona dhe Internship-i studentor

- 10.1. Qëllimi Strategjik
- 10.2. Vizioni
- 10.3. Objektivat Strategjike
- 10.4. Implementimi
- 10.5. Monitorimi dhe Vlerësimi

11. Zhvillimi i Masterplanit për një kampus bashkëkohor dhe modern

- 11.1. Vizioni
- 11.2. Misioni
- 11.3. Analiza SWOT
- 11.4. Objektivat Strategjike
- 11.5. Indikatorët Matës
- 11.6. Impaktet kryesorë strategjike

12. Plani për Digjitalizimin

- 12.1. Plan Zhvillimi
- 12.2. Digjitalizimi i integruar akademik dhe kërkimor- shkencor

13. Zhvillimi i UAMD-së në harmoni me strategjinë e zhvillimit të qytetit, rajonit dhe më

gjerë

- 13.1. Lidhja me Strategjitë Kombëtare dhe Evropiane
- 13.2. Strategjitë dhe Objektivat Evropiane
- 13.3. Vizioni dhe Misioni
- 13.4. Analiza SWOT
- 13.5. Prioritetet Strategjike dhe Objektivat deri në vitin 2040
- 13.6. Përfundime

1. Përmbledhje dhe qëllimi i dokumentit strategjik

Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit (FTI), si një nga njësitë kryesore akademike të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, e sheh zhvillimin e teknologjisë dhe formimin e specialistëve në fushën e informatikës dhe sistemeve digjitale si një përgjegjësi strategjike me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik, teknologjik dhe social të vendit. Në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit të UAMD-së për periudhën 2025–2030, fakulteti synon të konsolidojë profilin e tij akademik përmes ndërkombëtarizimit, duke u pozicionuar si një qendër referimi në fushën e teknologjisë së informacionit, kërkimit shkencor dhe inovacionit teknologjik në nivel rajonal dhe më gjerë, me fokus të veçantë në përgatitjen e studentëve për tregun e punës dhe sfidat e ekonomisë digjitale.

Ky dokument strategjik ka për qëllim të përcaktojë drejtimit kryesore të profilizimit të FTI-së përmes ndërkombëtarizimit, duke integruar dimensionin ndërkombëtar në mësimdhënie, kërkim shkencor, zhvillim institucional dhe bashkëpunim me industrinë. Ai mbështetet në një qasje gjithëpërfshirëse që synon bashkëpunim të strukturuar me institucionet publike, sektorin privat, universitete partnere dhe organizata ndërkombëtare që operojnë në fushën e teknologjisë dhe inovacionit.

Duke konsideruar si tepër të rëndësishme rritjen e cilësisë së arsimit të lartë dhe përgatitjen më të mirë të studentëve për sfidat e zhvillimeve teknologjike, FTI synon gjithashtu përfshirjen aktive të studentëve në procese akademike, kërkimore dhe projekte inovative.

Fokusi strategjik përfshin:

- internacionalizimin gradual të kurrikulave dhe harmonizimin e tyre me standardet evropiane në fushën e teknologjisë së informacionit;
- zgjerimin e mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve;
- zhvillimin e projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare kërkimore dhe aplikative;
- rritjen e publikimeve në revista ndërkombëtare dhe pjesëmarrjen në konferenca shkencore;
- organizimin e aktiviteteve akademike dhe shkencore me pjesëmarrje ndërkombëtare.

Strategjia e Fakultetit është në përputhje me prioritetet e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian, Strategjinë Kombëtare të Rinisë 2022–2029, Strategjinë Evropiane për Rininë 2019–2027, si dhe me kuadrin ligjor kombëtar për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, përfshirë Ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Ajo harmonizohet gjithashtu me dokumentet strategjike të zhvillimit rajonal dhe me prioritetet e universitetit në fushën e ndërkombëtarizimit dhe transformimit digjital.

FTI angazhohet të promovojë një qasje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse ndaj ndërkombëtarizimit dhe inovacionit teknologjik, duke krijuar mundësi të barabarta për studentët dhe stafin akademik dhe duke forcuar lidhjen midis arsimit universitar, kërkimit shkencor dhe zhvillimit të ekonomisë digjitale.

Përmes kësaj strategjie, fakulteti synon të forcojë rolin e tij si një njësi akademike që kontribuon në përgatitjen e specialistëve të aftë për të vepruar në një mjedis global dhe për të kontribuar në transformimin teknologjik dhe digjital të shoqërisë

1.1. Lidhja e Strategjisë së Zhvillimit të FTI me Misionin, Vlerat dhe Prioritetet Institucionale

FTI përbën një njësi akademike të rëndësishme brenda Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, me rol të drejtpërdrejtë në përgatitjen e specialistëve në fushën e teknologjisë së informacionit, informatikës dhe matematikës së aplikuar. Në përputhje me misionin e universitetit për të ofruar arsim cilësor, për të zhvilluar kërkimin shkencor dhe për të kontribuar në zhvillimin e inovacionit dhe të ekonomisë së dijes, FTI synon të konsolidojë profilin e tij akademik dhe kërkimor në përputhje me zhvillimet bashkëkohore teknologjike dhe nevojat e shoqërisë.

Oferta akademike e FTI përfshin programe studimi në ciklet bachelor dhe master në fusha të ndryshme të teknologjisë së informacionit dhe informatikës, si dhe programe që lidhen me matematikën dhe formimin e mësuesve në matematikë-informatikë. Këto programe synojnë përgatitjen e studentëve me njohuri teorike dhe praktike që u mundësojnë të përballen me sfidat e zhvillimeve të shpejta teknologjike dhe transformimit digjital të shoqërisë.

Në përputhje me misionin dhe prioritetet institucionale të UAMD, FTI synon të zhvillohet si një njësi akademike moderne, e orientuar drejt ndërkombëtarizimit, kërkimit shkencor dhe bashkëpunimit me institucionet publike dhe sektorin privat.

Profilizimi i Fakultetit do të mbështetet në:

- zhvillimin dhe përditësimin e programeve të studimit në fushën e teknologjisë së informacionit dhe informatikës, në përputhje me zhvillimet bashkëkohore teknologjike dhe nevojat e tregut të punës;
- integrimin e matematikës së aplikuar dhe formimit të mësuesve në matematikë-informatikë, në përputhje me nevojat e sistemit arsimor dhe zhvillimet e arsimit digjital;
- forcimin e kërkimit shkencor në fusha që lidhen me teknologjinë e informacionit, sistemet informatike dhe modelimin matematik;
- zhvillimin e bashkëpunimeve akademike dhe kërkimore me universitete dhe institucione ndërkombëtare.

Synimet afatgjata të FTI janë të konsolidojë pozicionin e tij si një njësi akademike që kontribuon në zhvillimin e teknologjisë dhe inovacionit në nivel rajonal, duke përgatitur specialistë të aftë për të operuar në një mjedis gjithnjë e më të ndërlidhur globalisht. Në këtë drejtim, fakulteti synon të forcojë cilësinë akademike të programeve të studimit, të zhvillojë kapacitetet kërkimore dhe të rrisë bashkëpunimet me universitete dhe institucione kërkimore brenda dhe jashtë vendit.

Në përputhje me prioritetet strategjike të universitetit, FTI do të kontribuojë gjithashtu në zhvillimin e një mjedisi akademik modern dhe inovativ, duke promovuar përdorimin e teknologjive digjitale në procesin mësimor dhe duke mbështetur zhvillimin e kompetencave që kërkohen nga ekonomia digjitale dhe shoqëria e dijes.

1.2. Lidhja e strategjisë së FTI me Kuadrin Strategjik Ndërkombëtar për Arsimin dhe Kërkimin Shkencor

Strategjia e zhvillimit të FTI për periudhën 2025–2030 ndërtohet në përputhje me prioritetet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e arsimit të lartë, kërkimit shkencor dhe inovacionit teknologjik. Në këtë kuadër, fakulteti synon të zhvillojë dhe të konsolidojë profilin e tij akademik përmes integritit të dimensionit ndërkombëtar në kurrikula, kërkim shkencor dhe bashkëpunime institucionale.

Kjo qasje është në përputhje me drejtimet strategjike të Bashkimit Evropian dhe organizatave ndërkombëtare që promovojnë zhvillimin e arsimit të lartë, kërkimit shkencor dhe inovacionit teknologjik. Përmes kësaj strategjie, fakulteti synon të kontribuojë në përgatitjen e specialistëve të aftë për të operuar në një mjedis global, si dhe në zhvillimin e kërkimit dhe inovacionit në fushën e teknologjisë së informacionit.

Në këtë kontekst, strategjia e fakultetit lidhet me disa prej kuadrove kryesore strategjike ndërkombëtare, si më poshtë:

1.2.1. Lidhja e Strategjisë së FTI me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDGs – Agenda 2030, OKB)

Në përputhje me Agjendën Globale 2030, FTI kontribuon në disa prej objektivave kryesore të zhvillimit të qëndrueshëm, veçanërisht në:

SDG 4 – Arsimi cilësor: Përmes zhvillimit të programeve bashkëkohore të studimit dhe përgatitjes së specialistëve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe matematikës së aplikuar.

SDG 5 – Barazia gjinore: Përmes promovimit të mundësive të barabarta për studentët dhe stafin akademik dhe inkurajimit të pjesëmarrjes së grave në fushat e teknologjisë dhe shkencës.

SDG 8 – Punë dinjitoze dhe rritje ekonomike: Përmes përgatitjes së studentëve me kompetenca që kërkohen nga tregu i punës dhe ekonomia digjitale.

SDG 9 – Inovacion dhe infrastrukturë: Përmes promovimit të kërkimit shkencor dhe zhvillimit të teknologjive inovative në fushën e informatikës dhe sistemeve digjitale.

SDG 16 – Institucione të forta dhe përfshirëse: Përmes promovimit të transparencës, etikës akademike dhe pjesëmarrjes së studentëve në proceset institucionale.

SDG 17 – Partneritete për qëllimet: Përmes zhvillimit të bashkëpunimeve akademike dhe kërkimore me universitete dhe institucione ndërkombëtare.

1.2.2. Lidhja e Strategjisë së FTI me Strategjinë e OKB-së për Rininë – “Youth 2030”

Duke e konsideruar FTI si një hapësirë të rëndësishme për formimin akademik dhe profesional të të rinjve, strategjia e zhvillimit të fakultetit synon të mbështesë përfshirjen aktive të

studentëve në proceset akademike, kërkimore dhe inovative.

Në këtë kuadër, FTI synon të kontribuojë në zhvillimin e kompetencave dhe mundësive për të rinjtë përmes:

- përfshirjes aktive të studentëve në projekte akademike dhe kërkimore;
- zhvillimit të kompetencave digjitale dhe profesionale që kërkohen nga tregu i punës;
- nxitjes së pjesëmarrjes së studentëve në aktivitete akademike dhe bashkëpunime ndërkombëtare;
- mbështetjes së iniciativave studentore që lidhen me inovacionin dhe teknologjinë.

Përmes kësaj qasjeje, FTI synon të kontribuojë në fuqizimin e të rinjve dhe në përgatitjen e tyre për të qenë pjesë aktive e zhvillimeve teknologjike dhe sociale në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

1.2.3. Lidhja e Strategjisë së FTI me Strategjinë Evropiane për Rininë 2019–2027

Strategjia e FTI është në përputhje me parimet dhe prioritetet e Strategjisë Evropiane për Rininë 2019–2027, e cila synon fuqizimin e të rinjve përmes arsimit cilësor, përfshirjes sociale dhe zhvillimit të kompetencave që kërkohen nga tregu bashkëkohor i punës.

Në këtë kuadër, fakulteti synon të mbështesë zhvillimin akademik dhe profesional të studentëve përmes:

- promovimit të mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik përmes programeve si Erasmus+;
- zhvillimit të moduleve mësimore me dimension ndërkombëtar dhe përdorimit të literaturës bashkëkohore;
- përfshirjes së studentëve në aktivitete akademike dhe projekte me partnerë ndërkombëtarë;
- nxitjes së inovacionit dhe zhvillimit të kompetencave digjitale dhe ndërkulturore.

Përmes këtyre iniciativave, FTI synon të krijojë një mjedis akademik që mbështet zhvillimin e të rinjve dhe përgatitjen e tyre për një treg pune gjithnjë e më të globalizuar dhe të orientuar drejt teknologjisë.

1.2.4. Lidhja e Strategjisë së FTI me Hapësirën Evropiane e Arsimit të Lartë (EHEA) – Procesi i Bolonjës

Strategjia e FTI mbështetet në parimet dhe standardet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA), të zhvilluara në kuadër të Procesit të Bolonjës, me qëllim rritjen e cilësisë së arsimit të lartë dhe lehtësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar midis universiteteve.

Në këtë kuadër, FTI synon të zhvillojë dhe të konsolidojë programet e studimit në përputhje me standardet evropiane nëpërmjet:

- zbatimit të sistemit të krediteve ECTS dhe strukturimit të programeve të studimit sipas cikleve të arsimit të lartë;
- harmonizimit të kurrikulave me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve dhe standardet ndërkombëtare të arsimit në teknologjinë e informacionit;
- promovimit të mobilitetit akademik të studentëve dhe stafit në bashkëpunim me universitete partnere;
- forcimit të mekanizmave të sigurimit të cilësisë në përputhje me standardet kombëtare dhe evropiane.

Me anë të kësaj qasjeje, FTI synon rritjen e cilësisë dhe transparencën e programeve të studimit, si dhe të forcojë integrimin e tij në hapësirën evropiane të arsimit të lartë.

1.2.5. Lidhja e Strategjisë së FTI me Horizon Europe 2021–2027

Në kuadër të zhvillimit të kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimit të aktiviteteve akademike, FTI synon rritjen e pjesëmarrjes në programe dhe iniciativa kërkimore të BE, veçanërisht në kuadër të programit Horizon Europe 2021–2027.

Në këtë drejtim, strategjia e fakultetit synon:

- rritjen e kapaciteteve për aplikime në projekte kërkimore ndërkombëtare;
- zhvillimin e bashkëpunimeve kërkimore me universitete dhe institucione ndërkombëtare në fushën e teknologjisë së informacionit;
- përfshirjen e stafit akademik dhe studentëve në projekte që adresojnë sfida bashkëkohore të teknologjisë dhe transformimit digjital;
- rritjen e publikimeve shkencore dhe pjesëmarrjen në konferenca ndërkombëtare.

Nëpërmjet këtyre iniciativave, FTI synon forcimin e rolit të tij në zhvillimin e kërkimit shkencor dhe pozicionimin e tij në bashkëpunimet akademike dhe kërkimore ndërkombëtare.

1.2.6. Lidhja e Strategjisë së FTI me Barazinë Gjinore si Prioritet Strategjik në UAMD

Në përputhje me dokumentet kombëtare dhe evropiane për barazinë gjinore, FTI e konsideron promovimin e mundësive të barabarta si një parim të rëndësishëm të zhvillimit institucional. Fakulteti synon të krijojë një mjedis akademik gjithëpërfshirës që mbështet pjesëmarrjen dhe zhvillimin akademik dhe profesional të studentëve dhe stafit pa dallim gjinie.

Në këtë drejtim, fakulteti angazhohet për:

- garantimin e mundësive të barabarta për studentë dhe staf në proceset akademike dhe kërkimore;
- promovimin e pjesëmarrjes së vajzave dhe grave në programet e studimit dhe aktivitetet akademike në fushën e teknologjisë së informacionit;

- krijimin e një mjedisi akademik të sigurt, gjithëpërfshirës dhe të respektueshëm për të gjithë;
- integrimin e perspektivës gjinore në aktivitetet akademike dhe kërkimore.

Në këtë mënyrë, fakulteti synon të kontribuojë në zhvillimin e një kulture institucionale që mbështet barazinë, përfshirjen dhe respektin brenda komunitetit akademik

II. Profilizimi i UAMD-së në kuadër të ndërkombëtarizimit

1) Gjendja aktuale dhe profili i FTI në UAMD

FTI kontribuon në zhvillimin e kompetencave digjitale dhe teknologjike të studentëve dhe në përgatitjen e profesionistëve që i përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe zhvillimeve të ekonomisë digjitale.

Në kuadër, ndërkombëtarizimi i programeve të studimit përbën një drejtim të rëndësishëm strategjik. Aktualisht, ndërkombëtarizimi në UAMD është përqendruar kryesisht në programe bashkëpunimi dhe mobilitet akademik, ndërsa për FTI synohet që ky proces të zhvillohet më tej në mënyrë të strukturuar përmes moduleve në gjuhë të huaj, programeve të përbashkëta me universitete partnere dhe projekteve ndërkombëtare kërkimore.

Pozicionimi strategjik i FTI në kuadër të ndërkombëtarizimit:

- FTI si një qendër akademike e orientuar drejt zhvillimit të teknologjisë së informacionit, sistemeve informatike dhe analizës së të dhënave, në përputhje me standardet evropiane të arsimit të lartë (ECTS, siguri i cilësisë, mobiliteti akademik).
- FTI si një njësi akademike që kontribuon në zhvillimin e kërkimit shkencor dhe inovacionit në fusha që lidhen me inteligjencën artificiale, analizën e të dhënave, sigurinë kibernetike dhe modelimin matematik.
- FTI si një partner aktiv për universitetin dhe komunitetin në zhvillimin e kompetencave digjitale, përmes projekteve akademike, bashkëpunimeve me industrinë dhe përfshirjes së studentëve në aktivitete praktike dhe kërkimore.

Profilizimi i fakultetit mbështetet gjithashtu në aktivitetin akademik të departamenteve që zhvillojnë programe studimi në teknologjinë e informacionit, shkencave kompjuterike dhe matematikë. Në këtë kuadër, departamenti i matematikës luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin e bazës teorike të programeve të studimit dhe në përgatitjen e mësuesve në fushën e matematikë-informatikës.

Në vitet në vijim, FTI synon të forcojë profilin e tij akademik dhe kërkimor përmes zhvillimit të programeve të studimit në fusha të avancuara të teknologjisë dhe përmes zgjerimit të bashkëpunimeve me universitete dhe institucione kërkimore ndërkombëtare.

2) Target SMART 2025–2030 për FTI

Duke u bazuar në objektivat strategjikë të UAMD për ndërkombëtarizimin e programeve të studimit dhe forcimin e bashkëpunimeve akademike ndërkombëtare, FTI përcakton disa objektiva të matshëm për periudhën 2025–2030.

SMART 1 (Programe / Module):

FTI tashmë ofron module në gjuhën angleze për studentët ndërkombëtarë në kuadër të mobiliteteve akademike dhe programeve të shkëmbimit.

Deri në vitin 2027, Fakulteti synon të zhvillojë të paktën një program studimi të ofruar në gjuhën të huaj, duke u mbështetur në përvojën e programeve ekzistuese dhe në bashkëpunimet akademike ndërkombëtare.

Deri në vitin 2030, synohet zgjerimi gradual i ofertës së moduleve në gjuhën angleze brenda programeve ekzistuese të studimit, në funksion të ndërkombëtarizimit të kurrikulave dhe rritjes së pjesëmarrjes së studentëve ndërkombëtarë.

Programi **Master në Quantum Information Technology**, i cili ofrohet plotësisht në gjuhën angleze, përbën një hap të rëndësishëm në këtë drejtim dhe një model për zhvillimin e mëtejshëm të programeve ndërkombëtare në fakultet.

SMART 2 (Partneritete Joint/Double):

Deri në vitin 2027, FTI synon të zhvillojë bashkëpunime më të strukturuar akademike me universitete partnere përmes zhvillimit të moduleve të përbashkëta, aktiviteteve akademike dhe iniciativave të përbashkëta kërkimore.

Deri në vitin 2030, synohet zgjerimi gradual i këtyre bashkëpunimeve përmes marrëveshjeve akademike dhe iniciativave të përbashkëta në nivel Bachelor, Master ose kërkimi shkencor.

SMART 3 (Mikrokredite & Edukim në Vazhdim):

Deri në vitin 2027, FTI synon të zhvillojë disa module me mikrokredite në fusha që lidhen me teknologjinë e informacionit dhe zhvillimet bashkëkohore digjitale.

Deri në vitin 2030, fakulteti synon të zgjerojë ofertën e këtyre moduleve në kuadër të edukimit në vazhdim, duke krijuar mundësi për përditësimin e njohurive profesionale dhe zhvillimin e kompetencave të reja teknologjike.

Këto module do të jenë të orientuara drejt temave që lidhen me zhvillimet aktuale të teknologjisë, si inteligjenca artificiale, analiza e të dhënave, siguria kibernetike dhe teknologjitë digjitale.

SMART 4 (Studentë & Mobilitet):

Deri në vitin 2030, FTI synon të rrisë pjesëmarrjen e studentëve dhe stafit akademik në programe mobiliteti dhe aktivitete akademike ndërkombëtare, përmes programeve si Erasmus+ dhe bashkëpunimeve me universitete partnere.

Në këtë drejtim, fakulteti do të mbështesë gjithashtu organizimin e aktiviteteve akademike dhe shkencore me pjesëmarrje ndërkombëtare, duke krijuar mundësi për shkëmbim përvojash dhe bashkëpunim kërkimor.

3) Riorganizimi i programeve ekzistuese (Audit + Reformim kurrikule)

Në përputhje me strategjinë e UAMD, FTI- realizon riorganizimin në 3 hapa:

3.1 Audit viti akademik (2025–2026)

- Analizë e programeve ekzistuese të studimit në drejtim të përputhjes së tyre me programe të ngjashme në universitete evropiane.
- Vlerësim i rezultateve të të nxënës (learning outcomes), strukturës së kurrikulave dhe komponentit praktik të programeve.
- Identifikim i lëndëve me literaturë ndërkombëtare dhe potencial për ofrim në gjuhën angleze.
- Analizë e përmbajtjes së programeve në raport me zhvillimet aktuale të teknologjisë së informacionit dhe kërkesat e tregut të punës.

3.2 Reformim kurrikule (2026–2030)

- Përditësim i përmbajtjes së programeve të studimit në përputhje me zhvillimet bashkëkohore në teknologjinë e informacionit.
- Shtim gradual i moduleve në gjuhën angleze brenda programeve ekzistuese të studimit.
- Integrim i moduleve ndërdisiplinore që lidhen me fusha si inteligjenca artificiale, analiza e të dhënave dhe siguria kibernetike.
- Zhvillim i moduleve që lidhin teknologjinë e informacionit me modelimin matematik dhe aplikimet e matematikës në teknologji.
- Përfshirje më e madhe e komponentit praktik përmes projekteve, laboratorëve dhe bashkëpunimeve me industrinë.
- Përfshirje aktive e stafit akademik në procesin e rishikimit të kurrikulave dhe mbështetje për zhvillimin e mëtejshëm profesional në fusha që lidhen me zhvillimet e reja në teknologji dhe në mësimdhënie.

4) Mekanizmat e ndërkombëtarizimit në FTI

4.1 Joint & Double Degrees (qasje graduale)

- Pilotim i një programi të përbashkët në nivel Master në bashkëpunim me një universitet partner, në fusha që lidhen me teknologjinë e informacionit dhe zhvillimet bashkëkohore digjitale.
- Përafrim gradual i kurrikulave me universitetet partnere, duke synuar njohjen reciproke të krediteve ECTS, zhvillimin e moduleve të përbashkëta dhe lehtësimin e mobilitetit akademik.
- Standardizim i procedurave për zhvillimin e programeve të përbashkëta, duke përfshirë rregullat e mobilitetit, mënyrat e vlerësimit dhe organizimin akademik të programeve.
- Krijimi i një grupi pune në nivel fakulteti për koordinimin dhe monitorimin e bashkëpunimeve akademike ndërkombëtare dhe zhvillimin e iniciativave Joint/Double Degree.

4.2 Kurrikul fleksibël dhe modulare

- Ristrukturim i programeve të studimit në module standarde me ECTS (core + elective), në përputhje me standardet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë.
- Hapje e disa moduleve të FTI për studentë nga fakultete të tjera të universitetit, si dhe për studentë ndërkombëtarë në kuadër të mobilitetit akademik.
- Zhvillim i “minor tracks” në fusha që lidhen me teknologjinë e informacionit, si p.sh. Artificial Intelligence, Data Science, Cybersecurity ose aplikime të matematikës në teknologji.
- Përdorimi i platformave digjitale për zgjedhjen e moduleve dhe monitorimin e progresit akademik të studentëve, në përputhje me zhvillimin e konceptit të “Digital Campus”.

4.3 Mobilitet virtual dhe projekte të përbashkëta online

- Zhvillimi i iniciativave **COIL (Collaborative Online International Learning)** përmes projekteve të përbashkëta online me universitete partnere në lëndë që lidhen me teknologjinë e informacionit dhe matematikën.
- Organizimi i leksioneve të hapura, seminareve dhe workshop-eve me pjesëmarrjen e profesorëve nga universitete partnere, si dhe ekspertëve nga industria dhe sektori i teknologjisë.
- Zhvillimi i aktiviteteve online dhe projekteve të përbashkëta që përfshijnë studentë, staf akademik dhe përfaqësues të bizneseve, me fokus në aplikimet praktike të teknologjisë dhe inovacionit.
- Organizimi i trajnimeve dhe aktiviteteve të përbashkëta me kompani dhe institucione që operojnë në fushën e teknologjisë, me qëllim zhvillimin e kompetencave praktike të studentëve dhe lidhjen e programeve të studimit me nevojat e tregut të punës.

5. Roli i Akreditimit në Strategjinë e Zhvillimit të FTI

Përfshirja e akreditimit si komponent strategjik synon të sigurojë që FTI jo vetëm të përmbushë detyrimet ligjore dhe standardet kombëtare të cilësisë, por edhe të zhvillojë një kulturë të brendshme të përmirësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit. Në këtë kuadër, procesi i akreditimit konsiderohet një instrument i rëndësishëm për garantimin e cilësisë akademike dhe për zhvillimin institucional të fakultetit.

Akreditimi i programeve të studimit ndihmon në përmirësimin e kurrikulave, në përditësimin e metodave të mësimdhënies dhe në forcimin e komponentit kërkimor të programeve. Përmes procesit të vetëvlerësimit dhe vlerësimit të jashtëm, fakulteti synon të sigurojë që programet e studimit të jenë në përputhje me standardet kombëtare dhe evropiane të arsimit të lartë.

Në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit, akreditimi luan gjithashtu një rol të rëndësishëm në garantimin e besueshmërisë institucionale dhe në zhvillimin e bashkëpunimeve akademike me universitete partnere.

Në këtë drejtim, FTI synon integrimin e procesit të akreditimit në planifikimin e zhvillimit akademik dhe të programeve të studimit.

Matat Strategjike për Akreditimin në kuadër të Planit afatgjatë 2030-2040

Qëllimi	Veprimet kryesore
---------	-------------------

Rritja e numrit të programeve të akredituara	• Proces i rishikimit të brendshëm të programeve të studimit në përgatitje për akreditim. • Përditësimi i kurrikulave në përputhje me standardet kombëtare dhe evropiane të sigurimit të cilësisë. • Organizimi i aktiviteteve informuese dhe trajnimeve për stafin akademik mbi proceset e sigurimit të cilësisë dhe akreditimit.
Integrimi i akreditimit në planifikimin akademik të FTI	• Zbatimi i procesit të akreditimit për të gjitha programet e studimit në përputhje me kuadrin ligjor të arsimit të lartë. • Hartimi i një kalendari të brendshëm për rishikimin periodik të programeve të studimit.
Zhvillimi i programeve ndërkombëtare dhe sigurimi i cilësisë së tyre	• Bashkëpunim me universitete partnere për zhvillimin e programeve të përbashkëta dhe përafrimin e kurrikulave. • Përdorimi i ekspertizës ndërkombëtare në zhvillimin dhe vlerësimin e programeve të studimit. • Vlerësimi i mundësisë për akreditim ndërkombëtar në përputhje me zhvillimin e programeve të reja.

6. KPI për FTI (2025–2030) – të lidhura me UAMD

Për të monitoruar zbatimin e strategjisë së zhvillimit dhe të procesit të ndërkombëtarizimit, FTI përcakton disa indikatorë kryesorë të performancës, të cilët do të përdoren për të vlerësuar progresin e arritur gjatë periudhës 2025–2030.

KPI kryesorë:

- numri i moduleve të ofruara në gjuhën angleze brenda programeve të studimit;
- zhvillimi i programeve të studimit në gjuhë të huaj (të paktën 1 deri në 2027) dhe konsolidimi i programeve ekzistuese ndërkombëtare;
- numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit Joint/Double me universitete dhe institucione ndërkombëtare (2 deri në 2027 dhe 5 deri në 2030);
- pjesëmarrja e studentëve dhe stafit akademik në programe mobiliteti ndërkombëtar;
- numri i projekteve kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare ku përfshihet stafi akademik i fakultetit;
- numri i aktiviteteve akademike dhe shkencore me pjesëmarrje ndërkombëtare;
- zhvillimi i moduleve me mikrokredite dhe programeve të edukimit në vazhdim në fusha që lidhen me teknologjinë e informacionit;
- bashkëpunimet me sektorin e industrisë dhe përfshirja e studentëve në projekte praktike dhe trajnime profesionale.

Profilizimi i FTI

Programet e studimit të fakultetit synojnë të zhvillojnë kompetenca teorike dhe praktike që lidhen me zhvillimet bashkëkohore të teknologjisë dhe transformimin digjital të shoqërisë.

Struktura akademike e fakultetit përfshin tre departamente kryesore: Departamentin e Teknologjisë së Informacionit, Departamentin e Shkencave Kompjuterike dhe Departamentin e Matematikës.

Departamenti i Teknologjisë së Informacionit zhvillon programe studimi që lidhen me sistemet informatike, zhvillimin e aplikacioneve dhe teknologjitë digjitale, duke përgatitur studentët për t'u integruar në sektorë të ndryshëm të industrisë së teknologjisë.

Departamenti i Shkencave Kompjuterike fokusohet në fusha që lidhen me programimin, algoritmet, strukturat e të dhënave dhe zhvillimin e sistemeve software, duke kontribuar në përgatitjen e specialistëve në zhvillimin dhe menaxhimin e sistemeve informatike.

Departamenti i Matematikës kontribuon në zhvillimin e bazës teorike të programeve të studimit dhe në përgatitjen e mësuesve në fushën e matematikë-informatikës. Përmes programeve të studimit dhe aktiviteteve akademike, departamenti synon të zhvillojë aftësitë analitike dhe logjike të studentëve, si dhe aplikimin e matematikës në fusha të ndryshme të teknologjisë dhe shkencës.

Në vitet në vijim, FTI synon të forcojë profilin e tij akademik dhe kërkimor përmes zhvillimit të programeve të studimit dhe aktiviteteve kërkimore në fusha që lidhen me inteligjencën artificiale, analizën e të dhënave, sigurinë kibernetike dhe aplikimet e matematikës në teknologji. Një rol të rëndësishëm në këtë drejtim luan edhe zhvillimi i programeve të studimit me dimension ndërkombëtar dhe bashkëpunimi me universitete dhe institucione kërkimore.

Në këtë kuadër, fakulteti synon gjithashtu të zhvillojë iniciativa kërkimore dhe projekte aplikative që lidhen me zhvillimin teknologjik dhe inovacionin. Përmes bashkëpunimit mes stafit akademik dhe studentëve, synohet zhvillimi i projekteve dhe prototipeve teknologjike që mund të kontribuojnë në krijimin e produkteve inovative dhe, në raste të veçanta, në zhvillimin e patentave dhe aplikimeve teknologjike me vlerë për shoqërinë.

Një dimension i rëndësishëm i këtij profilizimi lidhet edhe me kontributin e fakultetit në zhvillimin e komunitetit lokal. Në bashkëpunim me institucione publike, sektorin privat dhe aktorë të tjerë të komunitetit, fakulteti synon të mbështesë zhvillimin e projekteve që lidhen me transformimin digjital të shërbimeve, aplikime në fushën e **smart city**, sisteme informatike për menaxhimin e të dhënave dhe platforma digjitale që mund të kontribuojnë në përmirësimin e shërbimeve për qytetin e Durrësit.

Në këtë drejtim, fakulteti organizon dhe mbështet aktivitete si ideathon dhe hackathon, të cilat krijojnë hapësira për bashkëpunim mes studentëve dhe stafit akademik në zhvillimin e ideve dhe zgjidhjeve inovative për probleme konkrete të teknologjisë dhe komunitetit.

Strategjia e zhvillimit të fakultetit për periudhën 2025–2030 synon të konsolidojë profilin e FTI si një njësi akademike e orientuar drejt inovacionit, kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimit, duke forcuar njëkohësisht lidhjen me industrinë dhe tregun e punës.

III. Ruajtja e qëndrueshmërisë së FE-së dhe rritja nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar

Strategjia e FTI mbështetet në premisën se zhvillimi i teknologjisë dhe përgatitja e specialistëve në këtë fushë kërkon përshtatje të vazhdueshme ndaj zhvillimeve shkencore, teknologjike dhe socio-ekonomike. Në një mjedis akademik gjithnjë e më konkurrues në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, FTI synon të konsolidojë rolin e tij si një qendër akademike cilësore në fushën e teknologjisë së informacionit dhe matematikës.

Në këtë drejtim, fakulteti synon të forcojë bashkëpunimet ekzistuese me universitete dhe institucione ndërkombëtare të arsimit të lartë, si dhe të zhvillojë partneritete të reja akademike dhe kërkimore që mbështesin ndërkombëtarizimin e programeve të studimit dhe zhvillimin e kërkimit shkencor.

Krijimi i një mjedisi akademik bashkëpunues, ku studentët dhe stafi akademik kontribuojnë së bashku në procesin e mësimdhënies, kërkimit dhe inovacionit, përbën një nga shtyllat kryesore të zhvillimit të fakultetit. Në këtë kuadër, FTI synon të nxisë zhvillimin e projekteve aplikative, prototipeve teknologjike dhe iniciativave inovative, përfshirë aktivitete si ideathon dhe hackathon, të cilat krijojnë hapësira për zhvillimin e zgjidhjeve teknologjike në shërbim të komunitetit.

Forcimi i lidhjeve me institucionet publike, bizneset dhe komunitetin lokal është gjithashtu pjesë e rëndësishme e vizionit të Fakultetit për të kontribuar në transformimin digjital dhe zhvillimin teknologjik të qytetit të Durrësit dhe rajonit.

3.1 Metodologjia e hartimit të strategjisë në nivel fakulteti

Për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit të FTI-së për periudhën 2025–2030 është ndjekur një qasje gjithëpërfshirëse, e bazuar në analizën e Strategjisë së Zhvillimit të UAMD dhe në përshtatjen e saj me profilin dhe prioritetet e Fakultetit.

Procesi i hartimit të strategjisë është mbështetur në punën e një grupi pune të ngritur në nivel fakulteti, me përfaqësim nga departamentet e FTI. Në këtë proces janë marrë në konsideratë përvoja akademike e stafit, zhvillimet në fushën e teknologjisë dhe nevojat e tregut të punës.

Për hartimin e objektivave strategjikë janë përdorur analiza të dokumenteve institucionale, diskutime me stafin akademik dhe shqyrtimi i praktikave të universiteteve të tjera në fushën e teknologjisë së informacionit.

3.2. Analiza SWOT për ruajtjen e qëndrueshmërisë së FTI

Në kuadër të strategjisë së zhvillimit të UAMD dhe për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të FTI, është realizuar analiza SWOT me qëllim identifikimin e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në zhvillimin akademik dhe institucional të fakultetit.

Pikat e Forta

- Staf akademik i kualifikuar me grada dhe tituj shkencorë.
- Programe studimi të orientuara drejt zhvillimeve bashkëkohore të teknologjisë dhe kërkesave të tregut të punës.
- Bashkëpunime akademike me universitete dhe institucione ndërkombëtare.

- Organizimi i aktiviteteve akademike dhe inovative për studentët, si ideathon dhe hackathon.
- Mbështetje institucionale për zhvillimin e projekteve kërkimore dhe ndërkombëtarizimin e programeve të studimit.
- Përfshirje e studentëve në aktivitete kërkimore dhe projekte aplikative.

Dobësitë

- Infrastrukturë laboratorike që kërkon përmirësim dhe modernizim për të mbështetur zhvillimin e teknologjive bashkëkohore.
- Nevojë për pajisje kompjuterike me kapacitete më të larta memorie dhe programe bashkëkohore për zhvillimin e aktiviteteve praktike dhe kërkimore.
- Mungesë e programeve të studimit në nivel Bachelor të ofruara plotësisht në gjuhën angleze.
- Numër i kufizuar i programeve të përbashkëta me universitete ndërkombëtare.
- Nevojë për rritjen e përfshirjes së studentëve në projekte kërkimore dhe inovative.

Mundësitë

- Rritja e kërkesës për specialistë në fushën e teknologjisë së informacionit dhe ekonomisë digjitale.
- Mundësi financimi për projekte kërkimore dhe inovative përmes programeve të Bashkimit Evropian (Erasmus+, Horizon Europe).
- Zhvillimi i bashkëpunimeve me universitete dhe institucione ndërkombëtare në fushën e teknologjisë dhe shkencave kompjuterike.
- Interesi në rritje i bizneseve dhe kompanive të teknologjisë për të bashkëpunuar me universitetin në zhvillimin e programeve të reja studimi, praktikave profesionale dhe projekteve aplikative, me qëllim përgatitjen dhe punësimin e studentëve.
- Bashkëpunimi me industrinë dhe sektorin privat për zhvillimin e trajnimeve profesionale dhe projekteve inovative për studentët.
- Zhvillimi i teknologjive digjitale dhe aplikimeve në fusha si inteligjenca artificiale, analiza e të dhënave dhe siguria kibernetike.
- Zhvillimi i inkubatorëve të inovacionit dhe mbështetja e start-up-eve studentore në fushën e teknologjisë.

Kërcënimet:

- Konkurrenca nga universitete të tjera publike dhe private në fushën e teknologjisë së informacionit.
- Emigrimi i të rinjve dhe reduktimi i numrit të studentëve potencialë.
- Kufizimet buxhetore që ndikojnë në investimet për laboratorë dhe infrastrukturë teknologjike.
- Ritmi i shpejtë i zhvillimeve teknologjike që kërkon përditësim të vazhdueshëm të programeve të studimit dhe laboratorëve.

Në bazë të kësaj analize SWOT, FTI synon të ndërtojë një strategji zhvillimi të mbështetur në forcimin e kapaciteteve akademike dhe kërkimore, modernizimin gradual të infrastrukturës

laboratorike dhe zgjerimin e bashkëpunimeve me universitete ndërkombëtare dhe sektorin e industrisë. Duke shfrytëzuar potencialin e stafit akademik, interesin dhe energjinë e studentëve, si dhe mundësitë e bashkëpunimit me partnerë vendas dhe ndërkombëtarë, Fakulteti synon të përmirësojë në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e programeve të studimit, të forcojë dimensionin ndërkombëtar të tyre dhe të kontribuojë në zhvillimin teknologjik dhe inovativ të komunitetit dhe rajonit

3.3 Deklarata e Vizionit të FTI-së

3.3.1 Vizioni Strategjik i FTI-së

Në përputhje me misionin dhe orientimin strategjik të UAMD-së, FTI synon të jetë një njësi akademike e rëndësishme në përgatitjen e specialistëve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe matematikës, duke kontribuar në zhvillimin teknologjik, ekonomik dhe shoqëror të vendit dhe rajonit.

Vizioni i FTI është të konsolidohet si një fakultet bashkëkohor, inovativ dhe i orientuar drejt kërkimit shkencor dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, i cili formon specialistë të kualifikuar në teknologjinë e informacionit, shkencat kompjuterike dhe matematikë-informatikë, me kompetenca profesionale, digjitale dhe kërkimore të përshtatura me sfidat e zhvillimeve teknologjike të shekullit XXI.

Misioni i Strategjisë së Zhvillimit të FTI-së

Misioni i Strategjisë së Zhvillimit të FTI-së është të garantojë cilësi të lartë në përgatitjen akademike dhe profesionale të studentëve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe matematikës, duke u mbështetur në zhvillimet bashkëkohore shkencore dhe teknologjike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Nëpërmjet zhvillimit të kërkimit shkencor, inovacionit teknologjik dhe bashkëpunimeve me universitete dhe institucione partnere, fakulteti synon të kontribuojë në përgatitjen e specialistëve të aftë për t'iu përgjigjur kërkesave të tregut të punës dhe zhvillimeve të ekonomisë digjitale.

Fakulteti synon gjithashtu të krijojë një mjedis akademik bashkëpunues dhe stimulues për stafin dhe studentët, që nxit mendimin kritik, etikën profesionale dhe zhvillimin e iniciativave inovative në mësimdhënie dhe kërkim shkencor.

Parimet Themelore të Strategjisë së Zhvillimit

Strategjia e zhvillimit të FTI-së mbështetet në këto parime themelore:

- **Cilësi akademike dhe profesionalizëm** në përgatitjen e specialistëve të teknologjisë së informacionit dhe matematikës përmes programeve të studimit të harmonizuara me standardet kombëtare dhe evropiane.
- **Integrim i teorisë me praktikën**, përmes laboratorëve, projekteve aplikative, praktikave profesionale dhe bashkëpunimeve me industrinë dhe sektorin privat.
- **Kërkim shkencor dhe inovacion teknologjik**, duke nxitur zhvillimin e projekteve kërkimore dhe aplikative në fusha të ndryshme të teknologjisë.
- **Digjitalizim dhe zhvillim i kompetencave teknologjike**, për përgatitjen e studentëve

për mjedise bashkëkohore dhe dinamike të punës.

- **Ndërkombëtarizim i programeve të studimit dhe kërkimit shkencor**, përmes bashkëpunimeve me universitete dhe institucione ndërkombëtare.
- **Monitorim dhe përmirësim i vazhdueshëm institucional**, për të garantuar cilësi, transparencë dhe zhvillim të qëndrueshëm të fakultetit.

Në këtë kuadër, FTI synon të konsolidohet si një njësi akademike e rëndësishme në fushën e teknologjisë dhe matematikës, duke vendosur në qendër studentin, cilësinë akademike dhe lidhjen me zhvillimet bashkëkohore të teknologjisë dhe tregut të punës.

Shtyllat Strategjike të FTI

Vizioni i FTI do të realizohet duke u mbështetur në tri shtylla strategjike kryesore, të cilat synojnë të konsolidojnë rolin e fakultetit si një njësi akademike e rëndësishme në fushën e teknologjisë së informacionit dhe matematikës, si në nivel kombëtar ashtu edhe rajonal. Këto shtylla synojnë të mbështesin zhvillimin e programeve të studimit, kërkimit shkencor dhe bashkëpunimeve akademike dhe profesionale.

Shtyllat kryesore të zhvillimit janë:

- I. Transformimi digjital dhe zhvillimi i infrastrukturës akademike dhe laboratorike
- II. Ndërkombëtarizimi i programeve të studimit dhe i kërkimit shkencor në fushën e teknologjisë
- III. Bashkëpunimi me industrinë, inovacioni teknologjik dhe zhvillimi rajonal

Transformimi digjital dhe zhvillimi i infrastrukturës akademike dhe laboratorike

Qëllimet

- Modernizimi i infrastrukturës laboratorike dhe teknologjike në mbështetje të procesit mësimor dhe kërkimit shkencor.
- Digjitalizimi dhe përmirësimi i proceseve akademike dhe administrative në përputhje me zhvillimet bashkëkohore të teknologjisë.
- Zhvillimi i kompetencave digjitale dhe teknologjike të studentëve dhe stafit akademik.

Objektivat

- Modernizimi gradual i laboratorëve ekzistues dhe pajisja e tyre me teknologji dhe programe bashkëkohore për zhvillimin e aktiviteteve praktike dhe kërkimore.
- Përmirësimi i infrastrukturës kompjuterike përmes përdorimit të pajisjeve me kapacitete të përshtatshme për zhvillimin e aplikacioneve, analizën e të dhënave dhe projekteve teknologjike.
- Digjitalizimi i materialeve mësimore dhe përdorimi i platformave digjitale në mbështetje të procesit të mësimdhënies dhe të të nxënës.
- Përfshirja e teknologjive bashkëkohore, si inteligjenca artificiale dhe analiza e të dhënave, në procesin e mësimdhënies dhe në aktivitetet kërkimore.

Ndërkombëtarizimi i programeve dhe i kërkimit shkencor në fushën e teknologjisë

Qëllimet:

- Zgjerimi i bashkëpunimeve akademike dhe kërkimore me universitete dhe institucione ndërkombëtare.
- Zhvillimi i programeve të përbashkëta të studimit dhe i moduleve në gjuhë të huaj.
- Rritja e pjesëmarrjes së stafit akademik dhe studentëve në projekte dhe programe ndërkombëtare.
- Forcimi i kapaciteteve kërkimore të fakultetit në fusha të rëndësishme të teknologjisë së informacionit dhe matematikës.

Objektivat:

- Krijimi dhe zhvillimi i marrëveshjeve të reja të bashkëpunimit me universitete dhe institucione kërkimore ndërkombëtare.
- Zhvillimi i programeve të përbashkëta të studimit dhe diplomave të dyfishta në bashkëpunim me universitete partnere.
- Rritja e pjesëmarrjes në programe ndërkombëtare si Erasmus+, Horizon Europe dhe iniciativa të tjera kërkimore dhe akademike.
- Rritja e mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik përmes programeve të shkëmbimit dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare.
- Zhvillimi i aktiviteteve akademike dhe shkencore me pjesëmarrje ndërkombëtare, si konferenca, seminare dhe projekte kërkimore të përbashkëta.
- Zhvillimi gradual i programeve të studimit në gjuhë të huaj, duke synuar rritjen e pjesëmarrjes së studentëve ndërkombëtarë.
- Krijimi i kushteve akademike dhe institucionale për zhvillimin e programeve të studimit në ciklin e tretë në fusha që lidhen me teknologjinë e informacionit dhe matematikën, në përputhje me prioritetet strategjike të universitetit dhe me bashkëpunimet ndërkombëtare.
- Forcimi i kërkimit shkencor dhe i publikimeve akademike në revista ndërkombëtare, si dhe zhvillimi i projekteve të përbashkëta kërkimore me partnerë të huaj.

Bashkëpunimi me industrinë, inovacioni teknologjik dhe zhvillimi rajonal**Qëllimet**

- Forcimi i bashkëpunimit me bizneset dhe kompanitë e teknologjisë për zhvillimin e programeve të studimit dhe projekteve aplikative.
- Nxitja e inovacionit teknologjik dhe zhvillimi i ideve dhe projekteve të studentëve dhe stafit akademik.
- Kontributi në zhvillimin teknologjik dhe transformimin digjital të komunitetit dhe rajonit.

Objektivat

- Zhvillimi i bashkëpunimeve me kompani dhe institucione të sektorit të teknologjisë për praktikën profesionale dhe punësimin e studentëve.
- Përfshirja e përfaqësuesve të industrisë në aktivitete akademike, trajnime dhe zhvillimin e programeve të studimit.

- Organizimi i aktiviteteve inovative si hackathon dhe ideathon, të cilat nxisin zhvillimin e ideve dhe projekteve teknologjike nga studentët dhe stafi akademik.
- Mbështetja e projekteve aplikative që mund të çojnë në zhvillimin e produkteve teknologjike dhe zgjidhjeve digjitale në shërbim të komunitetit.
- Bashkëpunimi me institucionet vendore dhe organizatat e komunitetit për zhvillimin e projekteve që lidhen me transformimin digjital dhe shërbimet teknologjike.

3.3.2 Mekanizmat e monitorimit dhe vlerësimit

Për të siguruar zbatimin efektiv të Strategjisë së Zhvillimit të FTI-së do të zbatohet një proces i rregullt monitorimi dhe vlerësimi, i cili do të synojë të ndjekë progresin e arritjes së objektivave strategjikë dhe të mundësojë përmirësimin e vazhdueshëm të veprimtarisë akademike dhe institucionale të fakultetit.

Procesi i monitorimit dhe vlerësimit do të përfshijë:

- Hartimin e raporteve periodike mbi ecurinë e zbatimit të strategjisë, bazuar në indikatorët e përcaktuar të performancës .
- Mbledhjen e opinioneve dhe vlerësimeve nga studentët, stafi akademik dhe partnerët e jashtëm, përmes anketave dhe aktiviteteve konsultuese.
- Rishikimin periodik të strategjisë, në funksion të zhvillimeve të reja në fushën e teknologjisë, arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.
- Analizën e rezultateve të arritura dhe përshtatjen e objektivave strategjikë në përputhje me prioritetet institucionale dhe zhvillimet e mjedisit akademik dhe profesional.
- Përdorimin e indikatorëve krahasues për të vlerësuar zhvillimin e fakultetit në raport me institucione të tjera akademike në vend dhe në rajon.

Nëpërmjet këtij sistemi monitorimi dhe vlerësimi, FTI synon të garantojë transparencë, përgjegjshmëri institucionale dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së veprimtarisë akademike dhe kërkimore.

Ruajtja e qëndrueshmërisë së FTI-së në rrjetin e universiteteve shqiptare dhe rritja përmes bashkëpunimit ndërkombëtar

Qëllimi Strategjik

Të sigurohet një pozicionim i qëndrueshëm dhe konkurrues i FTI-së në nivel kombëtar dhe rajonal në fushën e arsimit të lartë në teknologji, përmes ndërkombëtarizimit të programeve të studimit, rritjes së mobilitetit akademik dhe zgjerimit të bashkëpunimeve ndërkombëtare në fushën e teknologjisë së informacionit, shkencave kompjuterike dhe matematikës.

Objektivat Specifikë

- Rritja e pjesëmarrjes së studentëve dhe stafit akademik në programe mobiliteti dhe bashkëpunimi ndërkombëtar.
- Zhvillimi gradual i programeve të studimit në gjuhë të huaj, në veçanti në gjuhën angleze.

- Thellimi i partneriteteve akademike dhe kërkimore me universitete dhe institucione ndërkombëtare.
- Zhvillimi i kapaciteteve kërkimore të stafit akademik në fusha të avancuara të teknologjisë.
- Krijimi i kushteve akademike dhe institucionale për zhvillimin e programeve të studimit në ciklin e tretë në fusha që lidhen me teknologjinë e informacionit dhe matematikën.

Nisma të Propozuara

- Zhvillimi i fushatave promovuese për programet e studimit të fakultetit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- Nënshkrimi i marrëveshjeve të reja bashkëpunimi me universitete dhe institucione kërkimore ndërkombëtare.
- Zhvillimi i programeve të përbashkëta të studimit dhe diplomave të dyfishta në bashkëpunim me universitete partnere.
- Organizimi i konferencave shkencore, seminareve dhe aktiviteteve akademike me pjesëmarrje ndërkombëtare.
- Përfshirja aktive në projekte kërkimore dhe programe të Bashkimit Evropian, si Erasmus+ dhe Horizon Europe.

Indikatorë të Matshëm (KPI) 2025–2030

- Rritje progresive e mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik në kuadër të programeve ndërkombëtare.
- Rritje e numrit të marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitete dhe institucione ndërkombëtare.
- Zhvillimi i programeve të studimit me komponent në gjuhën angleze.
- Rritja e pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare kërkimore dhe akademike.
- Rritja e numrit të publikimeve shkencore në revista të indeksuara ndërkombëtarisht.

IV. Përfshirja e studentëve në jetën universitare kulturore, sportive dhe kërkimore shkencore

Qëllimi Strategjik:

Të krijohet një mjedis universitar aktiv dhe gjithëpërfshirës, ku studentët e FTI të angazhohen përtej procesit mësimor në aktivitete akademike, kërkimore, kulturore dhe sportive, duke zhvilluar kreativitetin, aftësitë profesionale dhe kontributin e tyre në komunitet.

Objektivat specifike:

- Nxitja e pjesëmarrjes së studentëve në aktivitete akademike dhe kërkimore që lidhen me fushën e teknologjisë së informacionit dhe matematikës;
- Zhvillimi i aktiviteteve studentore me karakter kulturor dhe social në bashkëpunim me strukturat e universitetit;

- Inkurajimi i pjesëmarrjes së studentëve në aktivitete sportive dhe iniciativa të organizuara në nivel universiteti;
- Përfshirja e studentëve në projekte kërkimore dhe aplikative të zhvilluara në bashkëpunim me stafin akademik dhe partnerë të jashtëm.

Nisma të propozuara:

- Krijimi dhe mbështetja e klubeve studentore në fusha që lidhen me teknologjinë, programimin dhe inovacionin, si dhe në aktivitete kulturore dhe sportive;
- Organizimi i aktiviteteve studentore gjatë vitit akademik, si seminare, konkurse teknologjike, hackathon dhe ideathon, që nxisin kreativitetin dhe bashkëpunimin mes studentëve;
- Përfshirja e studentëve në projekte kërkimore dhe zhvillimore të drejtuara nga stafi akademik, përmes punëve të kursit, projekteve praktike dhe aktiviteteve kërkimore;
- Mbështetja e aktiviteteve studentore përmes infrastrukturës ekzistuese të universitetit, si biblioteka, laboratorë, salla trajnimi dhe ambiente sportive.

Indikatorë të matshëm (KPI):

- Organizimi i të paktën 1 aktiviteti studentor në muaj në nivel fakulteti ose universiteti;
- Rritje vjetore prej 10% e numrit të studentëve të përfshirë në aktivitete jashtë procesit mësimor;
- Rritje e numrit të studentëve të përfshirë në projekte kërkimore, aktivitete inovative dhe publikime shkencore;
- Nxitja, themelimi dhe mbështetja e klubeve të reja studentore, veçanërisht në fusha që lidhen me teknologjinë, programimin dhe inovacionin.

V. Ruajtja e Zhvillimi i marrëdhënieve të qëndrueshme me shkollat e mesme dhe komunitetin

Qëllimi Strategjik:

Të forcohen lidhjet e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit me shkollat e arsimit parauniversitar, institucionet arsimore dhe komunitetin lokal dhe rajonal, duke kontribuar në orientimin e të rinjve drejt studimeve në fushën e teknologjisë dhe duke konsoliduar rolin e fakultetit si një aktor aktiv në zhvillimin arsimor dhe teknologjik të komunitetit.

Objektivat specifike:

- Ndërtimi i një komunikimi të vazhdueshëm me shkollat e mesme dhe institucionet arsimore për promovimin e studimeve në fushën e teknologjisë së informacionit dhe matematikës;
- Rritja e njohjes së Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit në komunitetin lokal dhe rajonal;
- Nxitja e interesit të nxënësve për studimet në fushën e teknologjisë dhe për profesionet e lidhura me ekonominë digjitale.

Nisma të propozuara:

- Krijimi i një kalendari vjetor të vizitave në shkollat e mesme, në bashkëpunim me Drejtorinë Arsimore dhe mësuesit e karrierës;
- Organizimi i Ditëve të Hapura në FTI për nxënësit e viteve të fundit të shkollave të mesme;
- Organizimi i aktiviteteve informuese dhe prezantuese në shkolla, për të prezantuar programet e studimit dhe mundësitë e zhvillimit profesional në fushën e teknologjisë;
- Bashkëpunimi me bashkitë dhe institucione të tjera lokale për projekte edukative dhe teknologjike në shërbim të komunitetit;
- Promovimi i programeve të studimit të fakultetit përmes materialeve informuese, broshurave dhe prezantimeve në shkolla dhe aktivitete të tjera publike.

Indikatorë të matshëm (KPI):

- Shtim i përvitshëm i numrit të shkollave të mesme dhe institucioneve të vizituara nga përfaqësues të fakultetit;
- Rritje e pjesëmarrjes së nxënësve në aktivitetet **“Ditët e Hapura”** të organizuara nga fakulteti;
- Rritje e numrit të aplikimeve në programet e studimit të fakultetit nga maturantë që kanë marrë pjesë në aktivitetet promovuese;
- Zhvillimi i projekteve dhe aktiviteteve edukative në bashkëpunim me institucionet lokale dhe komunitetin.

VI. Kërkimi Shkencor në FTI

1) Roli i kërkimit shkencor në profilizimin dhe ndërkombëtarizimin e FTI

Në kuadër të strategjisë së zhvillimit të UAMD dhe procesit të ndërkombëtarizimit, kërkimi shkencor në FTI përbën një nga shtyllat kryesore të zhvillimit akademik dhe institucional. Kërkimi shkencor kontribuon drejtpërdrejt në:

- rritjen e cilësisë akademike përmes zhvillimit të kurrikulave të bazuara në zhvillimet bashkëkohore të teknologjisë dhe shkencës;
- ndërkombëtarizimin e fakultetit përmes bashkëpunimeve kërkimore, publikimeve me bashkautorësi ndërkombëtare dhe projekteve të përbashkëta;
- përmirësimin e reputacionit institucional përmes publikimeve në revista të indeksuara dhe pjesëmarrjes në projekte kërkimore ndërkombëtare;
- ndikimin në komunitet dhe sektorin e industrisë përmes zhvillimit të zgjidhjeve teknologjike dhe projekteve aplikative.

FTI synon të pozicionohet si një njësi akademike që zhvillon kërkim shkencor të lidhur ngushtë me zhvillimet bashkëkohore të teknologjisë dhe nevojat e shoqërisë dhe të ekonomisë digjitale. Në këtë kuadër, kërkimi shkencor fokusohet në fusha të tilla si inteligjenca artificiale, analiza e të dhënave, siguria kibernetike, zhvillimi i sistemeve software dhe aplikimet e matematikës në teknologji.

2) Vizioni dhe misioni i kërkimit shkencor në FTI

Vizioni:

Të zhvillohet si një qendër aktive kërkimi në fushën e teknologjisë së informacionit dhe matematikës, me kontribut në zhvillimin e inovacionit teknologjik, në bashkëpunimin ndërkombëtar akademik dhe në përmirësimin e aplikimeve digjitale në shoqëri dhe industri.

Misioni:

Të zhvillojë kërkim shkencor cilësor dhe të qëndrueshëm në fusha që lidhen me teknologjinë dhe aplikimet e saj, përmes:

- grupeve kërkimore dhe bashkëpunimeve ndërdisiplinore;
- publikimeve shkencore në revista të indeksuara;
- projekteve kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare;
- transferimit të rezultateve të kërkimit në projekte aplikative, produkte teknologjike dhe zgjidhje digjitale për komunitetin dhe industrinë.

3) Objektivat strategjike 2025–2030 për kërkimin në FTI**3.1 Forcimi i kapaciteteve kërkimore dhe bashkëpunimit ndërkombëtar**

- Krijimi i grupeve kërkimore në nivel departamenti dhe ndërdepartamentar që zhvillojnë aktivitete kërkimore në fusha të ndryshme të teknologjisë së informacionit dhe matematikës.
- Zgjerimi i bashkëpunimeve kërkimore me universitete dhe institucione ndërkombëtare, duke nxitur publikimet me bashkautorësi dhe projektet e përbashkëta.
- Rritja e pjesëmarrjes së stafit akademik në projekte kërkimore ndërkombëtare dhe në rrjete akademike në fushën e teknologjisë.

3.2 Strukturë e brendshme kërkimore në FTI

Në përputhje me strukturat kërkimore të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit synon të organizojë kapacitetet e tij kërkimore përmes krijimit të grupeve dhe iniciativave kërkimore në fusha të ndryshme të teknologjisë.

Në këtë kuadër mund të zhvillohen disa fusha kryesore kërkimi, si:

1. Inteligjenca Artificiale dhe Analiza e të Dhënave
2. Siguria Kibernetike dhe Sistemet e Informacionit
3. Zhvillimi i Software-it dhe Sistemet Digjitale
4. Matematikë e Aplikuar dhe Metoda Algoritmike
5. Teknologjitë Kuantike dhe aplikimet e tyre në informatikë

3.3 Sigurimi dhe rritja e fondeve kërkimore

- Rritja graduale e financimeve për aktivitetet kërkimore në nivel fakulteti për publikime, pjesëmarrje në konferenca dhe zhvillim projektesh.
- Diversifikimi i burimeve të financimit përmes pjesëmarrjes në programe dhe projekte ndërkombëtare si:
 - Erasmus+
 - Horizon Europe

- projekte kombëtare kërkimore
- bashkëpunime me institucione publike dhe sektorin privat.
- Nxitja e bashkëpunimeve me kompani dhe institucione të teknologjisë për zhvillimin e projekteve aplikative dhe inovative.

3.4 Kontribut në indeksimin dhe reputacionin shkencor (revista & botime)

FTI ka rol kyç në forcimin e botimeve të UAMD-së:

- Nxitjen e publikimeve shkencore në revista të indeksuara ndërkombëtarisht.
- Rritjen e pjesëmarrjes së stafit akademik në konferenca shkencore ndërkombëtare.
- Zhvillimin e aktiviteteve akademike dhe konferencave shkencore të organizuara nga fakulteti.

3.5 Përmirësimi i rankimit dhe impaktit

FTI kontribuon në rritjen e reputacionit akademik të universitetit përmes:

- publikimeve në revista të indeksuara ndërkombëtarisht;
- pjesëmarrjes në projekte kërkimore ndërkombëtare;
- zhvillimit të bashkëpunimeve kërkimore me universitete dhe institucione të tjera;
- kontributit në objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (SDG), veçanërisht në fusha që lidhen me inovacionin dhe zhvillimin teknologjik.

3.6 Rritja e cilësisë së kërkimit dhe kulturës akademike

- Organizimi i trajnimeve dhe aktiviteteve akademike mbi metodologjinë e kërkimit shkencor, shkrimin akademik dhe aplikimin në projekte kërkimore.
- Nxitja e pjesëmarrjes së stafit të ri akademik dhe studentëve në aktivitete kërkimore dhe projekte inovative.
- Organizimi i seminareve dhe workshop-ve akademike në fusha të ndryshme të teknologjisë dhe matematikës.

3.7 Sistem meritokratik dhe avancim akademik

Në përputhje me politikat institucionale të universitetit:

- aktiviteti kërkimor i stafit akademik vlerësohet përmes publikimeve shkencore, pjesëmarrjes në projekte dhe bashkëpunimeve akademike;
- mbështetet pjesëmarrja në konferenca dhe aktivitete kërkimore ndërkombëtare;
- nxitet zhvillimi i projekteve kërkimore dhe aplikative që kontribuojnë në zhvillimin shkencor dhe teknologjik të fakultetit.

4) Mekanizmat kryesorë të zbatimit në FTI

(A) Grupet kërkimore dhe bashkëpunimi ndërkombëtar

Një nga mekanizmat kryesorë për zhvillimin e kërkimit shkencor në FTI është krijimi dhe konsolidimi i grupeve kërkimore në nivel departamenti dhe ndërdepartamental.

- Çdo departament inkurajohet të zhvillojë të paktën një grup kërkimor aktiv në fushën e tij kryesore të ekspertizës.
- Grupet kërkimore do të nxisin bashkëpunimin ndërmjet stafit akademik, doktorantëve dhe studentëve të cikleve të ndryshme të studimit.
- Do të synohet krijimi i bashkëpunimeve kërkimore me universitete dhe institucione të huaja, duke nxitur publikime me bashkautorësi dhe projekte të përbashkëta kërkimore.

B) Zhvillimi i projekteve kërkimore dhe aplikimeve për financim

Për të rritur aktivitetin kërkimor, fakulteti do të inkurajojë zhvillimin e ideve kërkimore dhe përgatitjen e aplikimeve për projekte kombëtare dhe ndërkombëtare.

- Identifikimi i thirrjeve për projekte në programe si Erasmus+, Horizon Europe dhe programe të tjera kërkimore.
- Krijimi i ekipeve të vogla kërkimore për përgatitjen e aplikimeve për projekte.
- Mbështetja e stafit akademik në procesin e përgatitjes së projekteve dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare.

(C) Lidhja e kërkimit shkencor me mësimdhënien

- Rezultatet e kërkimit shkencor do të integrohen gradualisht në procesin e mësimdhënies dhe në zhvillimin e programeve të studimit.
- Përfshirja e temave kërkimore aktuale në kurset dhe modulet e programeve të studimit.
- Angazhimi i studentëve në projekte kërkimore dhe aplikative të drejtuara nga stafi akademik.
- Nxitja e projekteve studentore që lidhen me zhvillimin e zgjidhjeve teknologjike për probleme konkrete.

(D) Inovacioni teknologjik dhe bashkëpunimi me industrinë

- Fakulteti synon të zhvillojë një lidhje më të fortë ndërmjet kërkimit shkencor dhe aplikimit të tij në praktikë, përmes bashkëpunimeve me sektorin privat dhe institucionet publike.
- Bashkëpunimi me kompani të teknologjisë dhe institucione të tjera për zhvillimin e projekteve aplikative dhe zgjidhjeve digjitale.
- Organizimi i aktiviteteve inovative si ideathon, hackathon dhe gara studentore, ku studentët dhe stafi akademik mund të zhvillojnë ide dhe prototipe teknologjike.
- Nxitja e krijimit të produkteve teknologjike, aplikacioneve dhe zgjidhjeve digjitale që mund të kenë ndikim në komunitet dhe në zhvillimin ekonomik lokal.

(E) Etika dhe standardet e kërkimit shkencor

Zhvillimi i kërkimit shkencor në FTI do të mbështetet në respektimin e standardeve akademike dhe etike.

- Promovimi i etikës akademike dhe integritetit shkencor në publikime dhe projekte kërkimore.
- Respektimi i standardeve ndërkombëtare për citimin, publikimin dhe menaxhimin e të dhënave kërkimore.
- Inkurajimi i praktikave të transparencës dhe bashkëpunimit në aktivitetin kërkimor.

5) KPI të matshëm për FTI (2025–2030)

Deri në 2027:

- rritje graduale e publikimeve shkencore me bashkautorësi ndërkombëtare nga stafi akademik i FTI.

- krijimi i të paktën 1 grupi kërkimor aktiv në nivel departamenti ose ndërdepartamental në fusha si inteligjenca artificiale, analiza e të dhënave, siguria kibernetike, matematika e aplikuar ose zhvillimi i sistemeve software.
- të paktën 1 aplikim në vit në projekte ndërkombëtare (Erasmus+, Horizon Europe, CBHE ose programe të tjera kërkimore) me pjesëmarrjen e stafit të FTL.
- përfshirja graduale e studentëve në projekte kërkimore dhe inovative të zhvilluara në kuadër të kurseve, praktikave apo aktiviteteve si ideathon dhe hackathon

Deri në 2030:

- rritje e qëndrueshme e publikimeve në revista të indeksuara ndërkombëtarisht (Scopus/WoS) nga stafi akademik i fakultetit.
- organizimi i aktiviteteve shkencore ndërkombëtare, si konferenca, workshop-e ose shkolla verore në fushën e teknologjisë së informacionit dhe matematikës.
- të paktën 50% e stafit akademik të trajnuar në fusha si metodologjia e kërkimit, shkrimi akademik, aplikimi për projekte kërkimore dhe grant writing.
- rritja e bashkëpunimeve me universitete dhe institucione ndërkombëtare për publikime të përbashkëta, projekte kërkimore dhe aktivitete akademike.
- zhvillimi i projekteve aplikative dhe produkteve teknologjike në bashkëpunim me studentët dhe partnerë nga sektori privat.
- kontribut në objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm (SDG), veçanërisht në fusha që lidhen me inovacionin, teknologjinë dhe barazinë në arsim.

6) Fazat e zbatimit (të harmonizuara me UAMD)

Faza I (2025–2027) – Konsolidimi

- krijimi dhe konsolidimi i grupeve kërkimore në nivel departamenti dhe ndërdepartamental;
- organizimi i trajnimeve për stafin akademik në metodologjinë e kërkimit dhe përgatitjen e projekteve kërkimore;
- mbështetja e pjesëmarrjes së stafit akademik në konferenca dhe aktivitete shkencore;
- zhvillimi i aktiviteteve inovative me studentët, si ideathon, hackathon dhe projekte aplikative.

Faza II (2027–2030) – Zgjerimi

- rritja e aplikimeve dhe pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare kërkimore;
- zgjerimi i bashkëpunimeve kërkimore me universitete dhe institucione ndërkombëtare;
- organizimi i aktiviteteve shkencore ndërkombëtare në nivel fakulteti;
- forcimi i lidhjes midis kërkimit shkencor, programeve të studimit dhe bashkëpunimit me industrinë.

(Perspektivë 2030–2040) – në linjë me UAMD

- konsolidimi i FTL si një njësi akademike aktive në kërkimin teknologjik dhe matematikor në nivel kombëtar dhe rajonal;
- zhvillimi i bashkëpunimeve ndërkombëtare më të avancuara në kërkim shkencor;

- krijimi i iniciativave kërkimore dhe inovative që kontribuojnë në zhvillimin teknologjik dhe digjital të komunitetit.

7) Monitorimi dhe rezultatet e pritshme

Monitorimi i zbatimit të strategjisë do të realizohet përmes:

- raportimit vjetor të aktivitetit kërkimor të fakultetit (publikime, projekte, aktivitete shkencore);
- vlerësimit periodik të progresit të grupeve kërkimore dhe projekteve të zhvilluara;
- përdorimit të indikatorëve të matshëm (KPI) për të analizuar progresin në kërkim dhe ndërkombëtarizim.

Rezultatet e pritshme (deri 2030):

- zhvillimi i një kulture kërkimore më aktive në fakultet;
- rritje e publikimeve shkencore dhe bashkëpunimeve ndërkombëtare;
- rritje e pjesëmarrjes në projekte kërkimore dhe aktivitete shkencore;
- zhvillimi i projekteve inovative dhe aplikimeve teknologjike në bashkëpunim me studentët dhe partnerët institucionalë.

VII. Përfshirja e FTI në projekte kërkimore – shkencore

1. Strategjia dhe Vizioni

Në përputhje me Strategjinë e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës 2025–2030, FTI e konsideron përfshirjen në projekte kërkimore dhe në ekosistemet e inovacionit si një nga mekanizmat kryesorë për zhvillimin akademik, ndërkombëtarizimin dhe rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor.

FTI ka një përvojë të konsoliduar në pjesëmarrjen në projekte ndërkombëtare, duke përfaqësuar universitetin në disa iniciativa të rëndësishme. Fakulteti ka qenë koordinator në disa projekte Erasmus+ në nivel universiteti, si dhe partner në projekte të tjera ndërkombëtare Erasmus+ dhe Horizon, duke kontribuar në zhvillimin e bashkëpunimeve akademike dhe shkencore me universitete dhe institucione të huaja.

Vizioni i FTI është të konsolidohet si një njësi akademike aktive në projekte kërkimore dhe inovative në fushën e teknologjisë së informacionit, matematikës dhe aplikimeve digjitale, duke integruar kërkimin shkencor me mësimdhënien dhe zhvillimin e zgjidhjeve teknologjike në shërbim të komunitetit dhe industrisë.

2. Përfshirja në projekte kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare

TI synon të rrisë në mënyrë të qëndrueshme pjesëmarrjen në projekte kërkimore dhe inovative në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, veçanërisht në programe si:

- Erasmus+ (Digital Education, Artificial Intelligence, Cybersecurity, ICT Innovation)
- Horizon Europe (Digital transformation, Artificial Intelligence, Data Science)
- COST Actions

- EIT HEI initiatives
- projekte kombëtare në teknologjinë e informacionit dhe matematikën e aplikuar
- projekte kërkimore në bashkëpunim me sektorin privat dhe institucionet publike.

Fushat prioritare:

- inteligjencën artificiale dhe analizën e të dhënave
- sigurinë kibernetike
- zhvillimin e sistemeve software dhe aplikacioneve digjitale
- matematikën e aplikuar dhe algoritmet
- teknologjitë kuantike dhe aplikimet e tyre në informatikë
- transformimin digjital dhe inovacionin teknologjik.
- zhvillimi profesional i mësuesve të matematikës

Projektet do të lidhen drejtpërdrejt me:

- publikime shkencore
- zhvillimin dhe modernizimin e kurrikulës
- përfshirjen e studentëve në kërkim dhe inovacion
- zhvillimin e produkteve dhe aplikimeve teknologjike
- bashkëpunimin me industrinë dhe institucionet publike.

3. Ndikimi i projekteve në zhvillimin e fakultetit

Përfshirja e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit në projekte kërkimore dhe inovative përfaqëson një mekanizëm të rëndësishëm për zhvillimin akademik dhe institucional të fakultetit.

Projektet kontribuojnë në disa dimensione kryesore:

- **Rritja e fondeve kërkimore**, përmes pjesëmarrjes në programe ndërkombëtare dhe bashkëpunimeve institucionale, duke krijuar mundësi për zhvillimin e infrastrukturës laboratorike dhe aktiviteteve shkencore.
- **Rritja e publikimeve të indeksuara dhe impaktit shkencor**, përmes bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe rezultateve kërkimore që rrjedhin nga projektet.
- **Ndërkombëtarizimi i fakultetit**, përmes rrjeteve akademike, projekteve të përbashkëta dhe mobiliteteve të stafit dhe studentëve.
- **Zgjerimi i mundësive për studentët**, përmes përfshirjes në projekte kërkimore, aktivitete inovative dhe zhvillimin e aftësive praktike në fusha të ndryshme të teknologjisë.
- **Zhvillimi i laboratorëve dhe kapaciteteve kërkimore**, veçanërisht në fusha si inteligjenca artificiale, analiza e të dhënave dhe siguria kibernetike.
- **Modernizimi i programeve të studimit**, duke integruar rezultatet e projekteve në kurrikula dhe metodologjitë e mësimdhënies.
- **Rritja e reputacionit institucional**, përmes dukshmërisë ndërkombëtare dhe pjesëmarrjes në projekte kërkimore dhe inovative.

Në këtë mënyrë, projektet funksionojnë si një mekanizëm i rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm të fakultetit dhe për forcimin e lidhjes midis kërkimit shkencor, mësimdhënies dhe inovacionit teknologjik.

4. Treguesit e suksesit (KPI)

Për të monitoruar progresin e FTI në përfshirjen në projekte kërkimore dhe inovative, do të përdoren disa tregues të matshëm.

Treguesit kryesorë përfshijnë:

- rritja e numrit të projekteve ndërkombëtare me pjesëmarrje të FTI, duke synuar zgjerimin e rolit të fakultetit si partner dhe koordinator projektsh;
- rritja e fondeve të siguruara nga projekte kërkimore ndërkombëtare dhe kombëtare;
- rritja e publikimeve shkencore që rrjedhin nga projektet dhe e bashkautorësisë ndërkombëtare;
- përfshirja e studentëve në projekte kërkimore dhe inovative;
- zgjerimi i bashkëpunimeve me universitete dhe institucione kërkimore ndërkombëtare;
- zhvillimi dhe përmirësimi i laboratorëve dhe kapaciteteve kërkimore në fakultet;
- integrimi i rezultateve të projekteve në zhvillimin e kurrikulës dhe në procesin mësimor.

Këta tregues do të monitorohen në mënyrë periodike dhe do të përdoren për vlerësimin e performancës kërkimore, planifikimin strategjik dhe raportimin institucional.

5. Fazat e zbatimit

Zbatimi i strategjisë për përfshirjen e FTI në projekte kërkimore dhe ekosisteme inovacioni do të realizohet në mënyrë të fazuar, duke siguruar konsolidimin gradual të kapaciteteve institucionale dhe zgjerimin e rolit të fakultetit në hapësirën akademike ndërkombëtare.

Faza I (2025–2027) – Konsolidimi i kapaciteteve

Në këtë fazë do të konsolidohen kapacitetet ekzistuese të fakultetit për pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare.

- mbështetja e stafit akademik në përgatitjen e aplikimeve për projekte;
- zhvillimi i trajnimeve për shkrimin e projekteve dhe menaxhimin e tyre;
- krijimi i ekipeve kërkimore për aplikime në projekte ndërkombëtare;
- përfshirja e studentëve në aktivitete kërkimore dhe inovative të lidhura me projektet.

Faza II (2027–2030) – Zgjerimi dhe konsolidimi ndërkombëtar

Në këtë fazë synohet rritja e pjesëmarrjes së fakultetit në projekte ndërkombëtare dhe marrja e roleve më aktive në konsorciume kërkimore.

- zgjerimi i bashkëpunimeve me universitete dhe institucione ndërkombëtare;
- rritja e rolit të fakultetit në koordinimin ose bashkëdrejtimin e projekteve;
- integrimi i rezultateve të projekteve në kurrikula dhe në zhvillimin e laboratorëve kërkimorë

Perspektiva afatgjatë (2030–2040) – Pozicionimi strategjik

Në perspektivë afatgjatë synohet forcimi i rolit të FTI në projekte kërkimore dhe inovative në fushën e teknologjisë së informacionit.

Përfshirja e FTI në projekte kërkimore dhe inovative përbën një element të rëndësishëm të strategjisë së zhvillimit të fakultetit. Përmes një qasjeje të integruar që lidh kërkimin shkencor, mësimdhënien dhe inovacionin teknologjik, FTI synon të forcojë kapacitetet kërkimore, të rrisë ndërkombëtarizimin dhe të kontribuojë në zhvillimin teknologjik të universitetit dhe komunitetit.

VIII. Rrjetëzimi Akademik dhe Potenciali Gjeografik i UAMD

Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit synon të forcojë pozicionin e tij në arenën ndërkombëtare përmes përfshirjes aktive në rrjete akademike evropiane dhe globale në fushën e teknologjisë së informacionit, matematikës së aplikuar dhe inovacionit digjital, në përputhje me orientimin strategjik të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës.

Përfshirja në rrjete ndëruniversitare forcon identitetin akademik të fakultetit, rrit dukshmërinë ndërkombëtare dhe krijon mundësi për:

- zhvillimin e programeve të përbashkëta dhe diplomave të dyfishta në fushën e teknologjisë së informacionit dhe matematikës;
- mobilitet të strukturuar të stafit dhe studentëve;
- projekte kërkimore të përbashkëta në fusha të ndryshme të teknologjisë;
- shkëmbim përvojash dhe praktikash të mira akademike;
- zhvillimin e bashkëpunimeve me universitete dhe institucione kërkimore në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.

Strategjia dhe Vizioni

Qëllimi i FTI-së është të pozicionohet si një njësi akademike aktive dhe e dukshme në rrjetet ndërkombëtare të teknologjisë dhe kërkimit shkencor, duke kontribuar në zhvillimet bashkëkohore në fusha si:

- inteligjenca artificiale dhe analiza e të dhënave;
- siguria kibernetike;
- zhvillimi i sistemeve software dhe aplikacioneve digjitale;
- matematika e aplikuar dhe algoritmet;
- transformimi digjital dhe inovacioni teknologjik;
- teknologjitë e reja dhe aplikimet e tyre në industri dhe shoqëri.

Pjesëmarrja aktive në rrjete akademike dhe kërkimore do të shërbejë si katalizator për:

- rritjen e cilësisë së programeve të studimit;
- përmirësimin e kërkimit shkencor në teknologji dhe matematikë;
- ndërkombëtarizimin e përmbajtjeve mësimore;
- krijimin e mundësive për zhvillimin e programeve të përbashkëta të studimit.

Aktivitetet e Sugjeruara në Nivel Fakulteti

- Identifikimi i rrjeteve akademike dhe kërkimore më të përshtatshme për profilin e FTI dhe aplikimi për anëtarësim.
- Përgatitja e materialeve institucionale që pasqyrojnë profilin akademik të fakultetit, përfshirë programet e studimit, projektet kërkimore dhe publikimet shkencore.
- Nxitja e pjesëmarrjes së stafit akademik dhe studentëve në konferenca, seminare dhe aktivitete të organizuara nga rrjetet ndërkombëtare.
- Zhvillimi i partneriteteve me universitete dhe institucione kërkimore për projekte të përbashkëta dhe aktivitete akademike.
- Zgjerimi gradual i bashkëpunimeve akademike dhe kërkimore edhe me institucione jashtë hapësirës evropiane.

Përfitimet për FTI:

- rritja e dukshmërisë ndërkombëtare dhe reputacionit akademik të fakultetit;
- krijimi i mundësive për pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare dhe sigurimin e fondeve kërkimore;
- rritja e mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik;
- shkëmbimi i njohurive dhe praktikave të mira me universitete dhe institucione kërkimore ndërkombëtare;
- zhvillimi i programeve të përbashkëta të studimit dhe bashkëpunimeve kërkimore;
- forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e teknologjisë dhe inovacionit.

Treguesit e Suksesit (KPIs)

- numri i rrjeteve akademike dhe kërkimore ndërkombëtare ku FTI është anëtar aktiv;
- numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitete dhe institucione kërkimore ndërkombëtare;
- numri i projekteve të aplikuara dhe të fituara në partneritet me institucione ndërkombëtare;
- pjesëmarrja e stafit dhe studentëve në aktivitete ndërkombëtare si konferenca, seminare dhe trajnime;
- zhvillimi i programeve të përbashkëta të studimit me partnerë ndërkombëtarë;
- raportet periodike mbi ndikimin e rrjeteve akademike në ndërkombëtarizimin dhe zhvillimin e fakultetit.

IX. Bashkëpunimi me Diasporën

FTI e konsideron diasporën shqiptare një burim të rëndësishëm për zhvillimin e bashkëpunimeve akademike dhe kërkimore në nivel ndërkombëtar. Përfshirja e akademikëve dhe profesionistëve të diasporës në aktivitetet e fakultetit kontribuon në rritjen e cilësisë së kërkimit shkencor, në zgjerimin e bashkëpunimeve ndërkombëtare dhe në transferimin e përvojave akademike nga universitete dhe institucione kërkimore jashtë vendit.

Në përputhje me orientimin strategjik të UAMD-së, Fakulteti synon të zhvillojë dhe të forcojë bashkëpunimin me diasporën akademike përmes:

- përfshirjes së studiuesve dhe ekspertëve të diasporës në projekte kërkimore të përbashkëta;

- zhvillimit të publikimeve shkencore në bashkëpunim me akademikë shqiptarë që punojnë në universitete dhe institucione kërkimore ndërkombëtare;
- organizimit të leksioneve, seminareve dhe aktiviteteve akademike me pjesëmarrjen e studiuesve të diasporës;
- bashkëpunimit në zhvillimin e projekteve ndërkombëtare dhe iniciativave kërkimore në fushën e teknologjisë së informacionit dhe matematikës së aplikuar.

Strategjia dhe Vizioni në Nivel Fakulteti

FTI synon të zhvillojë një bashkëpunim të qëndrueshëm me diasporën akademike shqiptare në fusha të ndryshme të teknologjisë dhe kërkimit shkencor, duke krijuar ura bashkëpunimi ndërmjet universitetit dhe komunitetit akademik shqiptar në botë.

Ky bashkëpunim do të fokusohet në:

- zhvillimin e projekteve të përbashkëta kërkimore;
- publikime shkencore dhe bashkëpunime akademike ndërkombëtare;
- shkëmbimin e përvojave dhe praktikave akademike në fushën e teknologjisë;
- mbështetjen e aktiviteteve kërkimore dhe inovative të fakultetit.

Në këtë mënyrë, bashkëpunimi me diasporën kontribuon në rritjen e ndërkombëtarizimit të fakultetit dhe në forcimin e lidhjeve akademike të universitetit me komunitetin shkencor shqiptar në nivel global.

Integrimi në rrjetet e diasporës akademike

Në nivel fakulteti, do të ndërmerren disa masa për të forcuar bashkëpunimin me diasporën akademike shqiptare:

- identifikimi dhe hartëzimi i akademikëve dhe profesionistëve shqiptarë që punojnë në universitete dhe institucione kërkimore ndërkombëtare;
- organizimi i aktiviteteve akademike me pjesëmarrjen e studiuesve të diasporës;
- përfshirja e stafit dhe studentëve në rrjete akademike dhe kërkimore ku janë të angazhuar studiues të diasporës;
- zhvillimi i bashkëpunimeve për projekte kërkimore dhe publikime shkencore.

Indikatorë të përmbledhur:

- numri i akademikëve të diasporës të angazhuar në aktivitete akademike të fakultetit;
- numri i publikimeve shkencore të realizuara në bashkëpunim me studiues të diasporës;
- numri i projekteve kërkimore të zhvilluara në partneritet me institucione ku punojnë studiues të diasporës;
- numri i aktiviteteve akademike të organizuara me pjesëmarrjen e studiuesve shqiptarë që veprojnë në universitete ndërkombëtare.

X. Integrimi i Praktikave Profesionale në kurrikulat e programeve të Fakultetit të Edukimit dhe internship-i studentor

10.1 Qëllimi Strategjik

Në përputhje me orientimin institucional për rritjen e punësimit dhe forcimin e lidhjes ndërmjet universitetit dhe tregut të punës, FTL e konsideron praktikën profesionale dhe internship-in studentor një komponent thelbësor të formimit universitar.

Integrimi i praktikave në kurrikul synon që studentët të zhvillojnë jo vetëm njohuri teorike, por edhe aftësi praktike në fusha të ndryshme të teknologjisë së informacionit dhe matematikës së aplikuar, duke u përballur me situata reale të zhvillimit të software-it, analizës së të dhënave, administrimit të sistemeve dhe zgjidhjeve teknologjike në organizata dhe kompani.

Përmes këtij modeli synohet që studentët të përfitojnë përvojë konkrete në kompani teknologjike, institucione publike, start-up-e dhe organizata që operojnë në sektorin e teknologjisë dhe inovacionit.

Në rastin e programit të studimit **Mësuesi në Matematikë-Informatikë**, praktikat profesionale zhvillohen në bashkëpunim me institucione të arsimit parauniversitar, duke i mundësuar studentëve përvojë reale në mjedisin shkollor dhe zhvillimin e kompetencave pedagogjike dhe didaktike.

10.2 Vizioni

Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit synon të ndërtojë një model të qëndrueshëm të praktikave profesionale ku teoria dhe praktika të ndërthuren gjatë gjithë ciklit të studimeve.

Praktika profesionale nuk do të jetë vetëm një fazë përmbyllëse e programit të studimit, por një proces i vazhdueshëm formimi që zhvillohet progresivisht gjatë studimeve.

Studentët do të kalojnë nga:

- observimi i proceseve teknologjike dhe organizative në kompani ose institucione;
- përfshirja si asistentë në projekte teknologjike dhe zhvillim software;
- realizimi i projekteve praktike dhe internship-eve të mbikëqyrura në mjedise profesionale.

Internship-i studentor konceptohet si një hap i rëndësishëm në tranzicionin nga arsimi universitar drejt tregut të punës, duke krijuar mundësi reale për punësim dhe zhvillim profesional.

Në mënyrë të veçantë për studentët e programit **Mësuesi në Matematikë-Informatikë**, praktika pedagogjike synon të ndërthurë përgatitjen teorike me përvojën reale të mësimdhënies në shkolla 9-vjeçare dhe të mesme, duke zhvilluar aftësi didaktike, menaxhim të klasës dhe përdorim të teknologjisë në mësimdhënie.

10.3 Objektivat Strategjike

Integrimi i praktikës profesionale në kurrikulë

Praktikat profesionale dhe internship-et do të përfshihen në mënyrë të strukturuar në programet e studimit të fakultetit.

Kjo përfshin:

- përfshirjen e praktikës profesionale me kredite ECTS në programet e studimit;
- zhvillimin e projekteve praktike në bashkëpunim me kompani dhe institucione;

- lidhjen e praktikës me laboratorët teknologjikë dhe lëndët profesionale;
- dokumentimin e kompetencave përmes projekteve dhe portofolit profesional të studentit.

Ndërtimi i partneriteteve me sektorin e industrisë dhe institucionet publike

Fakulteti do të zhvillojë një rrjet bashkëpunimi me kompani dhe institucione që operojnë në sektorin e teknologjisë.

Në këtë kuadër synohet:

- nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit me kompani teknologjike dhe institucione publike;
- përfshirja e studentëve në projekte praktike dhe internship-e;
- organizimi i aktiviteteve të përbashkëta si seminare, trajnime dhe gara inovative.

Zhvillimi i praktikave pedagogjike për programin Mësuesi Matematikë-Informatikë

Në kuadër të programit të studimit në **Mësuesi në Matematikë-Informatikë**, Fakulteti zhvillon praktikat pedagogjike në bashkëpunim me institucione të arsimit parauniversitar.

Praktikat realizohen në **shkolla 9-vjeçare dhe të mesme**, ku studentët kanë mundësi të zhvillojnë kompetencat didaktike dhe pedagogjike të nevojshme për profesionin e mësuesit.

Në këtë drejtim Fakulteti synon:

- zhvillimin e praktikave pedagogjike të strukturuar në bashkëpunim me shkollat partnere;
- përfshirjen progresive të studentëve në procesin e mësimdhënies;
- bashkëpunimin me mësues mentorë në shkolla dhe udhëheqësit akademikë nga fakulteti;
- lidhjen e praktikës pedagogjike me lëndët e didaktikës së matematikës dhe informatikës.

Mentorimi i praktikave profesionale

Praktika profesionale do të mbështetet në një model mentorimi që përfshin:

- mentorin në institucionin ose kompaninë pritëse;
- udhëheqësin akademik nga fakulteti.

Ky bashkëpunim garanton që përvoja praktike të jetë e strukturuar dhe e lidhur me objektivat e programit të studimit.

Zhvillimi i internship-eve dhe projekteve praktike

Fakulteti do të nxisë zhvillimin e internship-eve dhe projekteve praktike në bashkëpunim me sektorin privat dhe institucionet publike.

Në këtë kuadër do të promovohen:

- internship-e në kompani teknologjike dhe institucione publike;
- projekte praktike në laboratorët e fakultetit;
- aktivitete inovative, ku studentët mund të zhvillojnë zgjidhje për probleme reale.

10.4 Implementimi

Strukturat e konsoliduara dhe mekanizmat e koordinimit

Implementimi i praktikave profesionale do të realizohet përmes strukturave ekzistuese të fakultetit dhe universitetit.

Në këtë kuadër fakulteti do të:

- forcojë rolin e koordinatorit të praktikës profesionale;
- bashkëpunojë me Zyrën e Karrierës dhe Zyrën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare;
- koordinojë aktivitetet ndërmjet stafit akademik, mentorëve dhe institucioneve partnere;
- zhvillojë një sistem raportimi për praktikat dhe internship-et studentore.

10.5 Monitorimi dhe Vlerësimi

Monitorimi i praktikave profesionale do të realizohet përmes:

- raporteve të studentëve dhe mentorëve mbi përvojën praktike;
- vlerësimin të kompetencave të fituara përmes projekteve dhe portofolit profesional;
- analizës së punësimit të të diplomuarve;
- raporteve periodike nga Zyra e Karrierës dhe Alumni.

Ky proces do të ndihmojë në përmirësimin e vazhdueshëm të praktikave dhe në përshtatjen e tyre me kërkesat e tregut të punës.

10.6 Rezultatet e pritshme për FTI

Në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale priten këto rezultate:

- çdo student të përfitojë përvojë praktike në projekte ose institucione reale;
- rritje e punësimit të të diplomuarve në sektorin e teknologjisë dhe arsimit;
- zhvillim i partneriteteve të qëndrueshme me kompani dhe institucione arsimore;
- rritje e përfshirjes së studentëve në projekte inovative dhe aktivitete teknologjike;
- përmirësim i përgatitjes profesionale të studentëve për tregun e punës.

XI. Zhvillimi i Masterplanit për një kampus bashkëkohor e modern

Vizioni

Kampusi i ardhshëm universitar synon të krijojë një mjedis akademik bashkëkohor, i cili mbështet zhvillimin e arsimit të lartë, kërkimit shkencor dhe inovacionit teknologjik. Në këtë kuadër, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit do të kontribuojë në ndërtimin e një ekosistemi universitar modern, që integron teknologjinë, kreativitetin dhe bashkëpunimin ndërdisiplinor.

Kampusi i së ardhmes mbështetet mbi tre shtylla kryesore:

Kampus akademik cilësor

Deri në vitin 2030, kampusi synon të garantojë kushte të avancuara për mësimdhënie dhe kërkim shkencor përmes zhvillimit të infrastrukturës moderne akademike, laboratorëve teknologjikë dhe bibliotekës digjitale universitare.

Në këtë kuadër Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit do të kontribuojë në zhvillimin e:

- laboratorëve modernë të teknologjisë së informacionit;
- laboratorëve të programimit, inteligjencës artificiale dhe analizës së të dhënave;
- hapësirave për projekte teknologjike dhe kërkim aplikativ.

Kampus digjital dhe inovativ

Në periudhën 2025–2030 synohet transformimi i universitetit në një **smart campus**, ku teknologjitë digjitale përdoren për menaxhimin efikas të proceseve akademike dhe

administrative.

Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit do të luajë një rol të rëndësishëm në këtë proces përmes:

- zhvillimit dhe testimit të sistemeve digjitale universitare;
- përfshirjes së studentëve në projekte teknologjike për menaxhimin e shërbimeve universitare;
- aplikimit të zgjidhjeve inovative për transformimin digjital të kampusit.

Kampus i hapur ndaj komunitetit dhe inovacionit

Kampusi universitar synon të shndërrohet në një hapësirë bashkëpunimi ndërmjet universitetit, industrisë dhe komunitetit, duke promovuar inovacionin teknologjik dhe sipërmarrjen akademike.

Në këtë drejtim Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit do të kontribuojë përmes:

- organizimit të aktiviteteve inovative si hackathon dhe ideathon;
- zhvillimit të projekteve teknologjike në bashkëpunim me industrinë;
- krijimit të hapësirave për inovacion dhe startup-e studentore.

Misioni

Bazuar në misionin e Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit synon të kontribuojë në ndërtimin e një kampusi universitar inovativ dhe të qëndrueshëm që:

- mbështet cilësinë akademike dhe zhvillimin e kërkimit shkencor në fushën e teknologjisë dhe matematikës së aplikuar;
- ofron një përvojë universitare të pasur për studentët përmes laboratorëve modernë dhe hapësirave të inovacionit;
- promovon digjitalizimin e proceseve universitare dhe zhvillimin e shërbimeve të integruara digjitale;
- forcon bashkëpunimin me komunitetin lokal dhe sektorin e industrisë teknologjike.

Objektivat strategjikë

Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit është pjesë e rëndësishme e masterplanit të zhvillimit të UAMD, i cili synon të harmonizojë cilësinë akademike, inovacionin teknologjik dhe mirëqenien studentore.

Objektivat afatmesëm (2025–2030)

Modernizimi i infrastrukturës akademike

- Përmirësimi dhe modernizimi i hapësirave të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit për të përmbushur standardet bashkëkohore të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.
- Krijimi dhe zhvillimi i laboratorëve të specializuar në fusha si:
 - inteligjenca artificiale dhe machine learning
 - programim dhe zhvillim software
 - siguri kibernetike
 - analiza e të dhënave dhe data science
 - matematikë e aplikuar dhe modelim matematikor.

Përmirësimi i kushteve të jetës studentore

- zhvillimi i hapësirave të dedikuara për projekte studentore dhe inovacion;
- mbështetje për aktivitetet studentore teknologjike dhe shkencore;
- përmirësimi i shërbimeve të orientimit në karrierë dhe bashkëpunimit me industrinë

Digjitalizimi i kampusit

- implementimi i sistemeve smart campus për menaxhimin e shërbimeve universitare;
- zhvillimi i platformave digjitale për administrimin e proceseve akademike;
- rritja e aksesit në internet me shpejtësi të lartë në të gjitha hapësirat universitare.

Objektivat afatgjatë (2035–2040)

Kampus i integruar dhe i zgjeruar

- zgjerimi i infrastrukturës universitare për të përballuar rritjen e programeve të studimit dhe të numrit të studentëve;
- zhvillimi i hapësirave të dedikuara për kërkimin shkencor dhe inovacionin teknologjik.

Smart campus i avancuar

- integrimi i inteligjencës artificiale dhe sistemeve inteligjente për menaxhimin e burimeve universitare;
- automatizimi i proceseve akademike dhe administrative;
- zhvillimi i sistemeve digjitale për analizën dhe menaxhimin e të dhënave universitare.

Zhvillimi i programeve të përbashkëta dhe kërkimit ndërkombëtar

- zgjerimi i bashkëpunimeve ndërkombëtare për programe të përbashkëta studimi;
- zhvillimi i projekteve kërkimore me universitete dhe institucione partnere;
- krijimi i mundësive për programe doktorature dhe bashkëpunime kërkimore ndërkombëtare.

Faza të zbatimit

Faza I :Planifikimi dhe prioritetet fillestare (2026–2027)

- përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese akademike;
- zhvillimi i platformave fillestare të menaxhimit digjital të shërbimeve universitare;
- planifikimi i laboratorëve të rinj teknologjikë.

Faza II : Zhvillimi i infrastrukturës (2027–2030)

- zhvillimi i laboratorëve të rinj teknologjikë dhe hapësirave të inovacionit;
- përparim i ndjeshëm në digjitalizimin e shërbimeve universitare.

Qasje transversale në të gjitha fazat

- përfshirja e studentëve dhe stafit në proceset vendimmarrëse;
- bashkëpunimi me industrinë dhe institucionet publike;
- rishikimi periodik i prioritetëve sipas zhvillimeve teknologjike dhe ekonomike.

Monitorim dhe vlerësim

Monitorimi i zhvillimit të masterplanit do të realizohet përmes mekanizmave institucionalë të raportimit dhe vlerësimit.

Procesi përfshin:

- raportime periodike nga fakulteti dhe departamentet për progresin e objektivave;

- përfshirjen e studentëve dhe stafit akademik në procesin e vlerësimit përmes anketave dhe forumeve;
- analizë të indikatorëve të performancës (KPI).

Indikatorët e monitorimit

- niveli i kënaqësisë së studentëve dhe stafit akademik për infrastrukturën dhe shërbimet universitare;
- përmirësimi i kushteve të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor;
- rritja e përdorimit të sistemeve digjitale universitare.

Rezultatet e pritshme

Rezultatet afatmesme (2025–2030)

- përmirësimi i infrastrukturës akademike dhe laboratorike;
- zhvillimi i një kampusi universitar më të digjitalizuar dhe inovativ;
- rritja e atraktivitetit të universitetit për studentët vendas dhe ndërkombëtarë.

Përfitimet për palët e interesuara

Studentët

- kushte më të mira studimi dhe akses në laboratorë modernë;
- mundësi për përfshirje në projekte teknologjike dhe inovative.

Stafi akademik

- infrastrukturë e përmirësuar për mësimdhënie dhe kërkim shkencor;
- mundësi më të mëdha për bashkëpunim me industrinë dhe partnerët ndërkombëtarë.

Komuniteti lokal

- rritje e aktiviteteve akademike dhe inovative;
- bashkëpunim më i fortë ndërmjet universitetit dhe sektorit të teknologjisë.

Impaktet kryesore strategjike

Akademik

- rritja e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor;
- zhvillimi i inovacionit dhe transformimit digjital.

Social

- përmirësimi i përvojës universitare të studentëve;
- forcimi i rolit të universitetit në zhvillimin e komunitetit.

Mjedisor

- krijimi i një mjedisi universitar të qëndrueshëm dhe të integruar me teknologjitë moderne.

XII. Plani për Digjitalizimin

12.1 Roli i digjitalizimit në zhvillimin e Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit

Digjitalizimi përbën një komponent thelbësor të zhvillimit të arsimit të lartë dhe është një nga shtyllat kryesore të modernizimit të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës. Në këtë kuadër, FTI ka një rol të veçantë në promovimin dhe implementimin e teknologjive digjitale në proceset akademike, kërkimore dhe administrative.

Laboratorët IT në FTI shërbejnë si qendra praktike për zhvillimin e aktiviteteve mësimore dhe

kërkimore, duke mundësuar zhvillimin e aftësive teknike dhe analitike të studentëve në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet më të fundit teknologjike.

Përdorimi i laboratorëve dhe platformave digjitale mbështet aplikimin e metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe nxit zhvillimin e kompetencave praktike të studentëve në fusha të ndryshme të teknologjisë së informacionit.

12.2 Infrastruktura digjitale dhe laboratorët teknologjikë

Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit synon të zhvillojë dhe të modernizojë infrastrukturën digjitale për të mbështetur mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe inovacionin teknologjik.

Në këtë kuadër synohet:

- zhvillimi dhe modernizimi i laboratorëve të teknologjisë së informacionit;
- krijimi i laboratorëve të specializuar për programim dhe zhvillim software;
- zhvillimi i laboratorëve për inteligjencë artificiale dhe analizë të të dhënave;
- përmirësimi i infrastrukturës së rrjeteve kompjuterike dhe internetit me shpejtësi të lartë.

Laboratorët teknologjikë do të shërbejnë jo vetëm për zhvillimin e aktiviteteve mësimore, por edhe për projekte kërkimore dhe zhvillim aplikacionesh teknologjike nga studentët dhe stafi akademik.

12.3 Platforma digjitale për mësimdhënie dhe administrim akademik

Në funksion të modernizimit të procesit të mësimdhënies dhe menaxhimit akademik, Fakulteti do të promovojë përdorimin e platformave digjitale të mësimit dhe administrimit universitar.

Në këtë kuadër synohet:

- përdorimi i platformave LMS;
- zhvillimi i materialeve digjitale mësimore për përdorim në procesin e mësimdhënies;
- integrimi i platformave digjitale për komunikimin ndërmjet studentëve dhe stafit akademik.

Këto sisteme do të mundësojnë akses të vazhdueshëm në materiale mësimore, detyra, projekte dhe aktivitete akademike.

12.4 Integrimi i cloud computing dhe laboratorëve virtualë

Në kuadër të zhvillimit të një mjedisi digjital bashkëkohor, Fakulteti synon të integrojë teknologjitë cloud për mbështetjen e procesit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Në këtë drejtim synohet:

- zhvillimi i laboratorëve virtualë që mund të aksesohen nga distanca;
- përdorimi i platformave cloud për zhvillimin e projekteve studentore dhe kërkimore;
- akses në infrastrukturë kompjuterike dhe mjete zhvillimi software nga distanca për studentët dhe stafin akademik.

Kjo qasje mundëson fleksibilitet më të madh në procesin e të nxënës dhe në realizimin e projekteve praktike.

12.5 Metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies

Digjitalizimi mbështet përdorimin e metodologjive moderne të mësimdhënies, të cilat nxisin pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe zhvillimin e kompetencave praktike.

Ndër metodologjitë kryesore përfshihen:

Blended Learning

Kombinimi i mësimi në klasë me mësimin online, duke përdorur platforma digjitale për shpërndarjen e materialeve dhe zhvillimin e aktiviteteve akademike.

Project-Based Learning

Zhvillimi i projekteve praktike nga studentët në laboratorët e fakultetit ose në bashkëpunim me kompani dhe institucione partnere.

Kjo metodologji nxit zhvillimin e aftësive analitike, teknike dhe bashkëpunuese të studentëve.

12.6 Përfitimet për studentët dhe stafin akademik

Digjitalizimi i proceseve akademike sjell përfitime të rëndësishme për komunitetin universitar.

Për studentët

- zhvillimi i aftësive praktike dhe teknike;
- përgatitje më e mirë për tregun e punës;
- akses i vazhdueshëm në materiale dhe laboratorë digjitalë;
- mësim më interaktiv dhe i orientuar drejt praktikës.

Për stafin akademik

- përdorimi i mjeteve digjitale për zhvillimin e mësimdhënies;
- mundësi për krijimin dhe shpërndarjen e materialeve digjitale;
- përmirësim i efikasitetit të procesit të mësimdhënies dhe vlerësimit.

12.7 Zhvillimi i kapaciteteve dhe trajnimi i stafit

Në kuadër të digjitalizimit të proceseve akademike, Fakulteti do të organizojë programe të vazhdueshme trajnimi për stafin akademik dhe administrativ.

Këto trajnime do të përfshijnë:

- përdorimin e platformave digjitale të mësimi;
- zhvillimin e materialeve mësimore digjitale;
- aplikimin e metodologjive moderne të mësimdhënies.

Synohet gjithashtu integrimi gradual i komponentëve digjitalë në të gjitha programet e studimit të fakultetit.

12.8 Digjitalizimi i integruar akademik dhe kërkimor

Digjitalizimi në FTI lidhet gjithashtu me zhvillimin e infrastrukturës për kërkimin shkencor dhe menaxhimin e informacionit akademik.

Në këtë kuadër synohet:

- krijimi i një repository institucional për kërkimin shkencor (Open Science);
- zhvillimi i një dashboard digjital për monitorimin e performancës akademike dhe kërkimore;
- integrimi i sistemeve për menaxhimin e krediteve ECTS, Diploma Supplement dhe indikatorëve të rankimit universitar.

Këto mekanizma do të kontribuojnë në përmirësimin e transparencës, menaxhimit akademik dhe ndërkombëtarizimit të universitetit.

XIII. Zhvillimi i Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës në harmoni me Strategjinë e Qytetit të Durrësit, Rajonit dhe më gjerë

Qyteti i Durrësit, si porti më i madh i vendit dhe një nga qendrat më të rëndësishme urbane dhe ekonomike të Shqipërisë, përbën një hapësirë strategjike për zhvillimin ekonomik, teknologjik dhe kulturor të rajonit. Me pozicionin e tij në Adriatik dhe me zhvillimin e vazhdueshëm të sektorëve të transportit, turizmit dhe shërbimeve, Durrësi po konsolidohet gjithnjë e më shumë si një nyje e rëndësishme rajonale për zhvillimin ekonomik dhe inovacionin.

Në këtë kontekst, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit, si një nga njësitë kryesore akademike të Universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin teknologjik, ekonomik dhe social të qytetit dhe rajonit.

Zhvillimi i Fakultetit do të orientohet nga:

- strategjitë vendore të zhvillimit ekonomik dhe teknologjik të Bashkisë Durrës;
- nevojat e tregut rajonal të punës në sektorin e teknologjisë dhe shërbimeve digjitale;
- politikat kombëtare për transformimin digjital dhe inovacionin;
- objektivat evropiane për ekonominë digjitale dhe zhvillimin e teknologjive të avancuara.

Në këtë mënyrë Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit synon të veprojë si një urë lidhëse midis arsimit të lartë, sektorit të industrisë dhe komunitetit lokal, duke kontribuar në zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe në transformimin digjital të rajonit.

Lidhja me Strategjitë Kombëtare dhe Evropiane

Strategjitë Kombëtare të Zhvillimit

Plani i zhvillimit të Fakultetit është në përputhje me dokumentet strategjike kombëtare të miratuara nga Qeveria Shqiptare, përfshirë:

- Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2030 (SKZHI 2030), e cila thekson rëndësinë e arsimit, kërkimit shkencor dhe inovacionit teknologjik për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror.
- Strategjinë Kombëtare të Arsimit të Lartë 2021–2030, e cila promovon ndërveprimin ndërmjet universiteteve dhe tregut të punës, si dhe ndërkombëtarizimin e arsimit të lartë.

Në këtë kuadër Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit kontribuon në prioritetet kombëtare për:

- zhvillimin e ekonomisë digjitale;
- rritjen e konkurrueshmërisë përmes inovacionit dhe teknologjisë;
- përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe punësimit të rinjve;
- transformimin digjital të institucioneve publike dhe private.

Strategjitë dhe Objektivat Evropiane

Në nivel evropian, Fakulteti e orienton zhvillimin e tij në përputhje me:

- Agjendën Evropiane për Arsimin e Lartë 2030;
- Strategjinë Evropiane për Transformimin Digjital;
- programet Horizon Europe dhe Erasmus+.

Në këtë kontekst, fakulteti synon të rrisë pjesëmarrjen në projekte kërkimore ndërkombëtare, mobilitete akademike dhe rrjete evropiane të kërkimit dhe inovacionit.

Përmes këtyre lidhjeve strategjike, FTI synon pozicionimin si një aktor aktiv në hapësirën akademike evropiane dhe në zhvillimin e ekonomisë digjitale në Shqipëri.

Roli i Fakultetit në Zhvillimin e Qytetit të Durrësit

Mbështetja e transformimit digjital të institucioneve lokale

Fakulteti do të kontribuojë në modernizimin e institucioneve publike dhe private të qytetit përmes:

- zhvillimit të projekteve për digjitalizimin e shërbimeve publike;
- bashkëpunimit me Bashkinë Durrës dhe institucione të tjera për zhvillimin e platformave digjitale;
- realizimit të projekteve studentore dhe kërkimore për zgjidhje teknologjike të problemeve lokale.

Bashkëpunimi me industrinë dhe sektorin privat

Në funksion të zhvillimit ekonomik të rajonit, Fakulteti do të forcojë bashkëpunimin me sektorin e industrisë dhe biznesit.

Në këtë kuadër synohet:

- zhvillimi i partneriteteve me kompani teknologjike dhe start-up;
- përfshirja e studentëve në praktika profesionale dhe projekte të përbashkëta;
- organizimi i aktiviteteve inovative si hackathon dhe ideathon.

Kontributi në zhvillimin teknologjik dhe inovativ të qytetit

Fakulteti do të kontribuojë në zhvillimin e ekosistemit të inovacionit në qytetin e Durrësit përmes:

- organizimit të aktiviteteve shkencore dhe teknologjike;
- zhvillimit të projekteve kërkimore në fusha si inteligjenca artificiale, analiza e të dhënave dhe siguria kibernetike;
- mbështetjes së iniciativave për sipërmarrje teknologjike dhe startup-e studentore.

Zhvillimi në harmoni me rajonin

Rajoni i Durrësit përballlet me nevoja në rritje për ekspertizë në teknologji dhe inovacion.

Në këtë kuadër Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit do të kontribuojë në:

- përgatitjen e specialistëve në teknologjinë e informacionit dhe analizën e të dhënave;
- zhvillimin e projekteve kërkimore që adresojnë sfidat teknologjike të rajonit;
- bashkëpunimin me institucione dhe organizata rajonale për projekte inovative.

Bashkëpunimi me institucionet rajonale

Fakulteti do të formalizojë bashkëpunime me:

- Bashkinë Durrës;
- institucionet publike dhe organizatat lokale;
- kompanitë dhe bizneset që operojnë në sektorin e teknologjisë.

Këto bashkëpunime do të mundësojnë:

- zhvillimin e praktikave profesionale cilësore;
- projekte kërkimore dhe inovative të përbashkëta;

- studime dhe analiza mbi zhvillimin teknologjik dhe ekonomik të rajonit.

Ndërkombëtarizimi në funksion të zhvillimit lokal

Ndërkombëtarizimi shihet si një mekanizëm për transferimin e njohurive dhe praktikave më të mira në zhvillimin lokal.

Në këtë kuadër Fakulteti synon:

- përfshirjen aktive në projekte **Erasmus+** dhe **Horizon Europe**;
- rritjen e mobilitetit të studentëve dhe stafit akademik;
- zhvillimin e projekteve kërkimore me partnerë ndërkombëtarë.

Përmes këtij dimensionit Fakulteti synon të kontribuojë në zhvillimin lokal përmes integritetit në rrjetet akademike dhe teknologjike ndërkombëtare.

Mbështetja e arsimit në STEM dhe transformimit digjital në shkolla

Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit do të kontribuojë në zhvillimin e arsimit në fushat STEM (Science, Technology, Engineering and Mathematics) dhe në përmirësimin e kompetencave digjitale në institucionet arsimore të qytetit të Durrësit dhe rajonit.

Në këtë kuadër Fakulteti do të:

- Forcojë bashkëpunimin me shkollat 9-vjeçare dhe gjimnazet e qytetit të Durrësit dhe rajonit për promovimin e arsimit në teknologji dhe matematikë.
- Organizojë trajnime dhe aktivitete orientuese për nxënësit dhe mësuesit në fusha si programimi, teknologjia e informacionit dhe përdorimi i mjeteve digjitale në arsim.
- Mbështesë zhvillimin profesional të mësuesve të matematikës dhe informatikës përmes seminareve dhe aktiviteteve të formimit të vazhdueshëm.
- Zhvillojë praktika pedagogjike për studentët e programit Mësuesi në Matematikë-Informatikë në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme të qytetit dhe rajonit.
- Organizojë aktivitete teknologjike dhe edukative për nxënësit, si gara programimi, hackathon dhe aktivitete orientuese në fushën e teknologjisë.

Qëllimi është që Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit të shndërrohet në një qendër referimi për zhvillimin e kompetencave digjitale dhe për promovimin e arsimit në teknologji dhe matematikë në qytetin e Durrësit dhe rajonit.

Qëllimet strategjike të Fakultetit

1. Të kontribuojë në zhvillimin teknologjik dhe ekonomik të qytetit të Durrësit dhe rajonit.
2. Të forcojë bashkëpunimin ndërmjet universitetit dhe industrisë.
3. Të integrojë kërkimin shkencor me nevojat reale të komunitetit dhe ekonomisë.
4. Të zhvillojë partneritete të qëndrueshme rajonale dhe ndërkombëtare.
5. Të fuqizojë rolin e studentëve si aktorë aktivë në inovacion dhe zhvillimin e komunitetit.

Indikatorët e Performancës (KPI)

Objektivi	Indikatori	Afati
Marrëveshje me institucione dhe kompani	≥ 20 marrëveshje aktive	2028
Trajnime për mësues	≥ 5 trajnime/vit	2026–2030
Projekte teknologjike dhe komunitare	≥ 5 projekte/vit	2030
Bashkëpunime me industrinë	≥ 5 partneritete aktive	2028
Projekte ndërkombëtare	≥ 5 projekte aktive	2030

Ndikimi i Pritur

Përmes këtij orientimi strategjik Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit do të:

- kontribuojë në zhvillimin teknologjik dhe ekonomik të qytetit dhe rajonit;
- rrisë punësimin e të diplomuarve në sektorin e teknologjisë dhe mesuesisë;
- forcojë lidhjen midis universitetit, industrisë dhe komunitetit;
- mbështesë transformimin digjital të institucioneve lokale.

Në këtë mënyrë Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit synon të konsolidohet si një njësi akademike moderne, inovative dhe e integruar në zhvillimin ekonomik dhe teknologjik të qytetit të Durrësit dhe rajonit.

Kontributi në zhvillimin ekonomik dhe teknologjik të qytetit të Durrësit

Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit synon të kontribuojë në zhvillimin ekonomik dhe teknologjik të qytetit të Durrësit përmes përgatitjes së specialistëve në fushën e teknologjisë së informacionit, matematikës së aplikuar dhe inovacionit digjital.

Në një kontekst ku ekonomia globale po transformohet nga teknologjitë digjitale, universitetet luajnë një rol kyç në përgatitjen e kapitalit njerëzor dhe në mbështetjen e inovacionit. Në këtë drejtim, Fakulteti do të kontribuojë në zhvillimin e sektorëve strategjikë të rajonit si:

- teknologjia e informacionit dhe shërbimet digjitale;
- transporti dhe logjistika e lidhur me portin e Durrësit;
- turizmi dhe shërbimet inteligjente për menaxhimin e destinacioneve turistike;
- digjitalizimi i institucioneve publike dhe shërbimeve lokale.

Përmes përfshirjes së studentëve dhe stafit akademik në projekte kërkimore dhe aplikative, Fakulteti do të kontribuojë në zhvillimin e zgjidhjeve teknologjike për problematika konkrete të komunitetit dhe sektorit të industrisë.

Ekosistemi i inovacionit dhe startup-eve

FTI synon të kontribuojë në krijimin e një ekosistemi inovacioni në qytetin e Durrësit, duke nxitur sipërmarrjen teknologjike dhe zhvillimin e ideve inovative nga studentët dhe stafi akademik.

Në këtë kuadër Fakulteti do të:

- mbështesë zhvillimin e projekteve inovative dhe aplikacioneve teknologjike nga studentët;
- organizojë aktivitete si hackathon, ideathon dhe gara teknologjike për zhvillimin e zgjidhjeve digjitale;

- bashkëpunojë me kompani dhe institucione për zhvillimin e projekteve të përbashkëta inovative;
 - nxisë krijimin e iniciativave startup nga studentët dhe të diplomuarit e fakultetit.
- Këto aktivitete synojnë të forcojnë lidhjen midis universitetit, industrisë dhe komunitetit, duke krijuar mundësi për zhvillimin e ideve inovative dhe për transformimin digjital të ekonomisë lokale.

XIV. Përfundime dhe Perspektiva Strategjike

Strategjia e zhvillimit të FTI përfaqëson një vizion të integruar për modernizimin e arsimit universitar, zhvillimin e kërkimit shkencor dhe forcimin e rolit të universitetit në shoqëri.

Në një kontekst global të karakterizuar nga transformimi digjital dhe zhvillimi i shpejtë i teknologjisë, universitetet kanë një rol të rëndësishëm në përgatitjen e profesionistëve të aftë për të përballuar sfidat e ekonomisë së dijes. Në këtë drejtim, FTI synon të zhvillohet si një njësi akademike moderne dhe inovative, e orientuar drejt cilësisë akademike, ndërkombëtarizimit dhe lidhjes së ngushtë me tregun e punës.

Një nga prioritetet kryesore të Fakultetit është zhvillimi i programeve të studimit që i përgjigjen kërkesave të tregut dhe zhvillimeve teknologjike dhe gjithashtu rritja e numrit të studentëve kombëtarë, ndërkombëtarë dhe nga diaspora. Përveç programeve në teknologjinë e informacionit dhe shkencat kompjuterike, një rol të rëndësishëm në këtë strategji ka edhe programi i studimit Mësuesi në Matematikë-Informatikë, i cili kontribuon në përgatitjen e mësuesve të kualifikuar për sistemin arsimor parauniversitar dhe në promovimin e arsimit në fushat STEM.

Përmes forcimit të kërkimit shkencor, zhvillimit të laboratorëve modernë dhe përfshirjes në projekte ndërkombëtare, Fakulteti synon të rrisë kontributin e tij në zhvillimin e dijes dhe inovacionit. Bashkëpunimi me universitete dhe institucione ndërkombëtare do të mbetet një nga shtyllat kryesore të zhvillimit, duke mundësuar mobilitet akademik, projekte të përbashkëta kërkimore dhe zhvillimin e programeve të studimit me dimension ndërkombëtar.

Një dimension tjetër i rëndësishëm i kësaj strategjie është lidhja e universitetit me komunitetin dhe sektorin e industrisë. Përmes praktikave profesionale, projekteve aplikative dhe aktiviteteve inovative si hackathon dhe ideathon, studentët do të kenë mundësi të zhvillojnë aftësi praktike dhe të përgatiten për tregun e punës.

Në të njëjtën kohë, Fakulteti synon të kontribuojë në zhvillimin teknologjik dhe ekonomik të qytetit të Durrësit dhe rajonit, duke mbështetur transformimin digjital të institucioneve dhe zhvillimin e një ekosistemi inovacioni.

Në perspektivë afatgjatë, FTI synon të konsolidohet si një qendër e rëndësishme akademike dhe kërkimore në fushën e teknologjisë së informacionit dhe matematikës së aplikuar në Shqipëri dhe rajon. Përmes zhvillimit të vazhdueshëm të kapaciteteve akademike, përmirësimit të infrastrukturës dhe zgjerimit të bashkëpunimeve ndërkombëtare, Fakulteti do të vazhdojë të kontribuojë në zhvillimin e arsimit, inovacionit dhe shoqërisë së dijes.

Kjo strategji përfaqëson një angazhim të përbashkët të stafit akademik, studentëve dhe partnerëve institucionalë për ndërtimin e një fakulteti modern, të hapur ndaj bashkëpunimit dhe të orientuar drejt së ardhmes.

